ASCAP

VEPRIMTARI PRAKTIKE

NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Klasa X

Art pamor, Teatër, Muzikë,
Edukim fizik, sport dhe shëndet

www.ascap.edu.al

2026

I. HYRJE **3**

II. QËLLIMI I UDHËZUESIT **4**

III. PËRDORUESIT E UDHËZUESIT **5**

IV. PARIMET PËR HARTIMIN E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE **6**

V. LIDHJA E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE ME REZULTATET E TË NXËNIT **8**

VI. VEPRIMTARITË PRAKTIKE PËR LËNDËT: ART PAMOR, TEATËR MUZIKË, EDUKIM FIZIK SPORTE DHE SHËNDET **9**

LËNDA: ART PAMOR 9

LËNDA: TEATËR 42

LËNDA: MUZIKË 71

LËNDA: EDUKIM FIZIK, SPORT DHE SHËNDET 84

I. HYRJE

Përditësimi i Kornizës Kurrikulare, i kurrikulave bërthamë dhe i programeve lëndore në arsimin parauniversitar ka sjellë nevojën për rishikimin e mënyrës së planifikimit dhe zhvillimit të procesit mësimor, duke e orientuar atë më qartë drejt të nxënit aktiv dhe përfshirjes së nxënësit në situata reale të të nxënit. Këto përditësime synojnë forcimin e koherencës ndërmjet qëllimeve kurrikulare, rezultateve të të nxënit dhe praktikës mësimore në klasë.

Veprimtaritë praktike gjatë orës mësimore përbëjnë një komponent thelbësor për përvetësimin e njohurive, koncepteve dhe aftësive, si dhe për arritjen e rezultateve të të nxënit. Ato u krijojnë nxënësve mundësi konkrete për të zbatuar njohuritë në situata nga jeta e përditshme dhe kontekste reale, për të zhvilluar aftësi praktike, për të ndërtuar njohuri të qëndrueshme dhe për të demonstruar kompetencat e synuara. Në këtë mënyrë, procesi mësimor zhvendoset nga një qasje e fokusuar kryesisht në transmetimin e njohurive drejt një të nxëni aktiv, të mbështetur në veprim, eksplorim, bashkëpunim dhe reflektim.

Përditësimet kurrikulare theksojnë gjithashtu përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, të cilat marrin në konsideratë diversitetin e nxënësve, ritmet e ndryshme të të nxënit dhe ndërlidhjen ndërmjet lëndëve. Në këtë kontekst, veprimtaritë praktike shërbejnë si element lidhës ndërmjet përmbajtjes së programeve lëndore dhe përvojave konkrete të nxënësve, duke ndikuar pozitivisht në motivimin dhe angazhimin e tyre në procesin e të nxënit.

Ky udhëzues synon të mbështesë mësuesit në zbatimin e programeve lëndore të përditësuara, duke ofruar shembuj orientues të veprimtarive praktike të strukturuara sipas cikleve arsimore, klasave dhe lëndëve përkatëse. Veprimtaritë e përfshira janë hartuar në përputhje me parimet e programit lëndor dhe synojnë të lehtësojnë planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e orëve mësimore që kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e kompetencave dhe përmbushjen e rezultateve të të nxënit.

II. QËLLIMI I UDHËZUESIT

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të shërbejë si një instrument mbështetës për mësuesit në zbatimin sa më cilësor të programeve të përditësuara lëndore, përmes veprimtarive praktike mësimore të orientuara drejt përmbushjes së rezultateve të të nxënit dhe zhvillimit të kompetencave kyçe, si dhe kompetencave specifike të lëndës. Ai synon të lehtësojë kalimin nga dokumenti kurrikular në zbatimin konkret të tij në klasë, duke ofruar shembuj veprimtarish të strukturuara, të shpjeguara qartë dhe të përshtatshme për kontekste të ndryshme mësimore.

Nëpërmjet veprimtarive të propozuara, udhëzuesi mbështet mësuesit në planifikimin dhe organizimin e situatave të të nxënit që nxisin pjesëmarrjen aktive të nxënësve, zhvillojnë mendimin kritik, aftësinë për zgjidhjen e problemeve, bashkëpunimin dhe komunikimin. Këto veprimtari synojnë të krijojnë lidhje funksionale ndërmjet njohurive teorike dhe përvojave konkrete në klasë, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet e reja, t'i zbatojnë ato në situata praktike dhe të ndërtojnë njohuri të qëndrueshme.

Udhëzuesi ofron orientime për përzgjedhjen dhe përdorimin e metodave dhe strategjive bashkëkohore të mësimdhënies, duke nxitur përshtatjen e tyre sipas karakteristikave të klasës, ritmeve dhe stileve të ndryshme të të nxënit, si dhe nevojave individuale të nxënësve. Në këtë mënyrë, ai kontribuon në zhvillimin e një mësimdhënieje gjithëpërfshirëse, fleksibile dhe të orientuar drejt nxënësit.

Gjithashtu, udhëzuesi synon të mbështesë koherencën ndërmjet planifikimit mësimor, zbatimit të orës së mësimit dhe vlerësimit të të nxënit, duke ndihmuar mësuesit të lidhin më qartë rezultatet e të nxënit me veprimtaritë konkrete. Kjo qasje ndihmon në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor dhe në monitorimin më të mirë të progresit të nxënësve.

Udhëzuesi synon të kontribuojë në unifikimin e praktikave mësimore, në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe në forcimin e rolit të mësuesit si lehtësues i të nxënit dhe udhëheqës pedagogjik në klasë, duke mbështetur zbatimin koherent dhe të qëndrueshëm të kurrikulës dhe programeve të përditësuara.

III. PËRDORUESIT E UDHËZUESIT

Ky udhëzues është hartuar për të mbështetur aktorë të ndryshëm të përfshirë në procesin arsimor, duke synuar zbatimin sa më efektiv të kurrikulës së përditësuar në praktikën e përditshme mësimore. Përdoruesit kryesorë të tij janë mësuesit e arsimit parauniversitar, sipas cikleve arsimore, klasave dhe lëndëve për të cilat janë hartuar veprimtaritë praktike. Për mësuesit, udhëzuesi shërben si material referues për planifikimin ditor, javor dhe afatmesëm të mësimit, duke ofruar shembuj veprimtarish që mund të përzgjidhen, përshtaten ose kombinohen në funksion të rezultateve të të nxënit, nivelit të klasës dhe karakteristikave të nxënësve.

Veprimtaritë e paraqitura nuk kanë karakter detyrues, ato janë orientuese dhe fleksibile, duke i lënë mësuesit hapësirë për përshtatje sipas kontekstit të klasës, ritmeve dhe stileve të ndryshme të të nxënit, si dhe nevojave individuale të nxënësve. Në këtë mënyrë, udhëzuesi lidhet drejtpërdrejt me procesin e planifikimit mësimor dhe me vlerësimin e të nxënit, duke ndihmuar mësuesit të ndërtojnë situata të të nxënit që mbështesin zhvillimin e kompetencave dhe monitorimin e progresit të nxënësve.

Udhëzuesi është gjithashtu një mbështetje për kryetarët e ekipeve lëndore dhe drejtuesit e rrjeteve profesionale, të cilët mund ta përdorin për të nxitur shkëmbimin e praktikave të mira, për të organizuar diskutime profesionale dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet mësuesve. Ai shërben si referencë e përbashkët për reflektim profesional dhe për harmonizimin e praktikave mësimore në nivel shkolle apo rrjeti.

Udhëzuesi përbën një burim të dobishëm edhe për trajnerët duke ofruar shembuj konkretë të praktikave mësimore dhe orientime për zhvillimin profesional të mësuesve. Në një këndvështrim informues, udhëzuesi mund të shërbejë edhe për prindërit, duke i ndihmuar të kuptojnë më qartë mënyrën se si organizohen veprimtaritë praktike dhe si lidhen ato me zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të nxënësve.

IV. PARIMET PËR HARTIMIN E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE

Hartimi dhe zbatimi i veprimtarive praktike në këtë udhëzues mbështetet në parimet themelore të kornizës kurrikulare dhe të programeve të arsimit parauniversitar. Është e rëndësishme të theksohet se ***udhëzuesi nuk trajton zhvillimin e plotë të një ore mësimore***, ***por ofron modele të veprimtarive të veçanta mësimore,*** të cilat mund të integrohen në struktura të ndryshme të orës, në varësi të planifikimit të mësuesit dhe qëllimeve të përcaktuara në programin lëndor.

Veprimtaritë janë ndërtuar në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit dhe sigurimit të koherencës ndërmjet programit lëndor, zbatimit në klasë dhe vlerësimit. Ato synojnë të konkretizojnë në praktikë përditësimet kurrikulare, duke mbështetur zhvillimin e nxënësit si individ aktiv, i përgjegjshëm dhe i aftë për të zbatuar njohuritë në situata të ndryshme.

Veprimtaritë praktike udhëhiqen nga këto parime:

- ✓ Qasja e bazuar në kompetenca. Çdo veprimtari synon integrimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve në situata konkrete të të nxënit, duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave kyçe dhe atyre specifike të lëndës.
- ✓ Nxënësi në qendër të procesit. Veprimtaritë marrin në konsideratë karakteristikat zhvillimore, interesat, ritmet dhe stilet e ndryshme të të nxënit, duke garantuar përfshirje aktive dhe angazhim kuptimplotë.
- ✓ Të nxënit aktiv dhe përmes përvojës. Të nxënit realizohet përmes veprimit, eksplorimit, analizës, diskutimit dhe reflektimit, duke nxitur ndërtimin e njohurive të qëndrueshme.
- ✓ Lidhja me kontekste reale. Veprimtaritë krijojnë mundësi për zbatimin e njohurive në situata autentike, duke rritur kuptimin dhe relevancën e të nxënit.
- ✓ Bashkëpunimi dhe komunikimi. Puna në grup, shkëmbimi i ideve dhe ndërveprimi i strukturuar kontribuojnë në zhvillimin e aftësive sociale dhe qytetare.

- ✓ Gjithëpërfshirja. Veprimtaritë janë konceptuar në mënyrë që të krijojnë mundësi reale pjesëmarrjeje për të gjithë nxënësit, duke respektuar diversitetin dhe nevojat individuale.
- ✓ Fleksibiliteti në zbatim. Veprimtaritë janë orientuese dhe mund të përshtaten sipas kontekstit të klasës, burimeve në dispozicion dhe nivelit të nxënësve, pa cenuar rezultatet e synuara.
- ✓ Vlerësimi për të nxënit. Vlerësimi integrohet natyrshëm brenda veprimtarisë, përmes vëzhgimit, pyetjeve orientuese, reflektimit dhe vetëvlerësimit, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të të nxënit.

V. LIDHJA E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE ME REZULTATET E TË NXËNIT

Veprimtaritë praktike të përfshira në këtë udhëzues janë hartuar në lidhje të drejtpërdrejtë me rezultatet e të nxënit të përcaktuara në programet lëndore, sipas tematikave përmbajtësore përkatëse. Kjo do të thotë se veprimtaria nuk paraqitet si aktivitet i izoluar, por si pjesë funksionale e arritjes së objektivave të përcaktuara në program.

Lidhja ndërmjet rezultateve të të nxënit dhe veprimtarive praktike bazohet në parimin e koherencës kurrikulare. Për secilën tematikë janë identifikuar rezultatet përkatëse dhe janë propozuar veprimtari që u krijojnë nxënësve mundësi reale për t'i demonstruar ato përmes veprimit, analizës, diskutimit, argumentimit apo zgjidhjes së situatave problemore. Në këtë mënyrë, fokusi nuk qëndron vetëm në përvetësimin e njohurive faktike, por në aftësinë për t'i përdorur ato në kontekste të ndryshme dhe për të ndërtuar kuptim të thelluar.

Përmes veprimtarive praktike, nxënësit kanë mundësi të tregojnë se kuptojnë konceptet, të aplikojnë njohuritë në situata të reja, të analizojnë informacionin, të bashkëpunojnë me të tjerët dhe të reflektojnë mbi procesin e të nxënit. Kjo e bën të dukshme arritjen e rezultateve jo vetëm në nivel njohurish, por edhe në nivel aftësish dhe qëndrimesh. Veprimtaritë krijojnë gjithashtu hapësirë për diferencim, duke i mundësuar mësuesit të përshtatë kërkesat sipas nivelit të nxënësve, pa devijuar nga rezultatet e synuara.

Kjo lidhje e qartë ndërmjet rezultateve të të nxënit dhe veprimtarive praktike mbështet mësuesin në planifikimin e qëndrueshëm të procesit mësimor dhe në përzgjedhjen e metodave të përshtatshme. Ajo lehtëson gjithashtu vlerësimin e progresit të nxënësve, pasi kriteret e vlerësimit mund të ndërtohen drejtpërdrejt mbi rezultatet që synohen të arrihen përmes veprimtarisë.

Udhëzuesi ofron një kornizë praktike që garanton koherencë ndërmjet planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit, duke e bërë procesin mësimor më të strukturuar, më transparent dhe më të orientuar drejt arritjeve konkrete të nxënësve.

VI. VEPRIMTARITË PRAKTIKE PËR LËNDËT: ART PAMOR, TEATËR MUZIKË, EDUKIM FIZIK SPORTE DHE SHËNDET

LËNDA: ART PAMOR

Tabela 1: Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën gjuha dhe komunikimi artistik

Rezultat i të nxënit	*Veprimtari praktike*
Identifikon përdorimin e pikës në vepra të ndryshme të artit dhe dizajnit dhe e përdor për të komunikuar mendimin e tij personal	E gjithë ora mësimore do të orientohet në identifikimin e mënyrave të larmishme të përdorimit të elementit të pikës si një mjet komunikimi në art dhe dizajn dhe përdorimin e këtij elementi në krijim. Hapi I: ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve*** (10 minuta) Mësuesi shfaq imazhe të veprave të artit dhe dezajnit ku elementi i pikës është i rëndësishëm në komunikimin e mendimit estetik dhe artistik dhe nxënësit/et vëzhgojnë përdorimin e pikës në këto imazhe. Ata diskutojnë: • Si ndryshon efekti kur pikat janë të vogla apo të mëdha? • Cfarë ndodh kur pikat janë shumë afër njëra tjetrës? • A ndikojnë në humor dhe energji oikat në një vepër arti?





Hapi II: ***Ndërtimi i njohurive të reja – analizë dhe eksperimentim*** (25 minuta)

	Nëpërmjet veprave të ndryshme të artit të shfaqura mësuesi/ja shpjegon mundësitë e shumta shprehëse të elementit të pikës. Gjatë vëzhgimit të imazheve nga piktura, dizajni, fotografia, artizanati, etj., nxënësit identifikojnë format e larmishme të përdorimit të këtij elementi. Duke u mbështetur në veprat e artit ku elementi i pikës është një mjet shprehës shumë i rëndësishëm si p.sh. veprat e Roi Lihtenshteinit, etj, Nxënësit orientohen të përdorin pikën për të theksuar sipërfaqen, ndarë format, krijuar theksin dhe hapësirat, me ngjyrën e dëshiruar. 



Nxënësit diskutojnë mbi veprat e vëzhguara dhe eksperimentimet e kryera cështje si:

- Ku shfaqet pika?
- Çfarë ndjesie krijon pikëzimi/pointizmi? A përdoret si dekor, ritëm apo emocion?

Nxënësit përmes eksperimenteve kuptojnë si pointizmi pëdoret në dizajn grafik, modë, art.

	Hapi III: ***Reflektimi*** (10 minuta)
	Reflektimi fokusohet
	
	• në identifikimin e formave të larmishme të përdorimit të pikës në vepra të ndryshme arti;
	• në mënyrën e realizimit të punimit artistik nga nxënësit duke shpjeguar :
	  ○ pse ka përdorur atë lloj pikëzimi?
	  ○ Si ka ndikuar dendësia e pikëzimit dhe ngjyra?
	  ○ Cfarë mesazhi përcjell punimi?
	• në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Përdor ngjyrën në mënyrë krijuese dhe shprehëse duke u	E gjithë ora mësimore do të orientohet në përdorimet e ngjyrës në mënyrë krijuese dhe shprehëse. Hapi I: ***Vëzhgim dhe analizë e veprave duke diskutuar*** (10 min)

mbështetur në vepra të ndryshme arti	Mësuesi prezanton vepra ku ngjyra përdoret për të shprehur emocion, atmosferë dhe ide artistike. Nxënësit analizojnë: • kontrastin e ngjyrave, • ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta, • emocionin që përcjell vepra, • stilin artistik. Shembuj nga vepra të artistëve: Vincent van Gogh, Pablo Picasso, Wassily Kandinsky Nxënësit diskutojnë: • mbi njohuritë dhe eksperiencat e tyre mbi elementin e ngjyrës si ngjyrat e para dhe të dyta, rrethi i ngjyrave, ngyrat e ngrohta dhe të ftohta, kontrasti i ngjyrave dhe,

- shprehen sesi shfaqen ato në veprat e artit.

Hapi II: ***Ndërtimi i njohurive të reja dhe veprimtaria – Eksperimentim nëpërmjet ngjyrave*** (25 minuta):

Nëpërmjet imazheve të veprave të ndryshme të artit nxënësit/et identifikojnë mundësitë shprehëse të ngjyrës, duke identifikuar . përdorimin e ngjyrave të pastra, kontrastin e toneve bardhezi të ngjyrave, kontrastin e ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta, kontrastin e ngjyrave plotësuese, mbizotërimin e një ngjyre, në vepra të ndryshme arti. Nxënësit zgjedhin një emocion:

- gëzim,
- qetësi,
- frikë,
- energji,
- melankoli

dhe e paraqesin vetëm përmes ngjyrave dhe formave.

Krijimi personal

	Duke u mbështetur në veprat e artistëve impresionist, të cilët ishin të interesuar kryesisht për efektin e dritës në momente të ndryshme të ditës, mbi subjektet që ata pikturonin, nxënësit nxiten të përzgjedhin një imazh fotografik ta rikrijojnë këtë imazh nëpërmjet siluetave (deri në tre herë), si në formë ashtu edhe të dritëhijeve, e më pas të përdorin raporte të ndryshme ngjyrash për secilin imazh duke zgjedhur teknikën sipas dëshirës. Ata përdorin ngjyrën në mënyrë: • krijuese, • simbolike, • shprehëse. Hapi III: ***Reflektimi*** (10 minuta). Reflektimi fokusohet në prezantimin e punës së krijuar duke shpjeguar: • pse zgjodhën ato ngjyra, • çfarë emocioni përcjell puna, • cilat vepra arti i frymëzuan.

	Gjithashtu ata ndalen : • në identifikimin e mundësive shprehëse të ngjyrës në vepra të ndryshme arti; • në mënyrën e realizimit të detyrës; • në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.
Identifikon lloje të ndryshme të përdorimit të teksturave në veprat e artit dhe përdor në mënyrë të qëllimshme teksturën për të komunikuar ide	Ora mësimore orientohet në identifikimin e përdorimin e teksturës në vepra të ndryshme të artit si një formë komunikimi dhe përdorimi i qëllimshëm i saj në punimet e nxënësve.

	Hapi I. ***Vëzhgimi dhe identifikimi i teksturës*** (10 min) Mësuesi prezanton vepra arti dhe materiale të ndryshme ku tekstura është e dukshme: • teksturë reale, • teksturë vizuale, • sipërfaqe të ashpra apo të lëmuara. Nxënësit identifikojnë: • çfarë ndjesie krijon tekstura, • si ndikon në emocionin e veprës, • cilat materiale janë përdorur. artistë referues: • Vincent van Gogh • Anselm Kiefer • Claude Monet Hapi II: ***Ndërtimi i njohurive të reja dhe veprimtaria*** - Cfarë komunikon tekstura dhe si e realizojmë atë (25 min):





Mësuesi/ja orienton që tekstura në një vepër arti realizohet në dy mënyra të ndryshme:

- nëpërmjet përzgjedhjes së materialit dhe
- mënyrës së përpunimit të tij.

Nëpërmjet shembujve të veprave të artit nxënësit identifikojnë karakteristikat e:

- Teksturën optike në pikturë,
- Tekstura fizike në pikturë,
- Tekstura në skulpturë,
- Tekstura në arkitekturë, dhe
- Tekstura si komunikim e udhërëfyes.

Veprimtari krijuese

Duke u mbështetur në këto mundësi shprehëse të teksturës, nxënësit nxiten të krijojnë një punim duke përzgjedhur teknikën sipas dëshirës. Nxënësit krijojnë një mini-kompozim artistik duke përdorur tekstura të ndryshme për të shprehur një ide (p.sh. natyra, ndotja, emocioni, koha). Ata duhet:

Të përdorin të paktën 2 lloje teksture

	Zgjedhin një ide për të komunikuar Shpjegojnë pse e kanë përdorur atë teksturë  Hapi III: ***Reflektimi*** (10 min). Reflektimi fokusohet: • në identifikimin e teksturës në vepra të ndryshme arti;

	• në mënyrën e realizimit të teksturës në punim personal; • në analizën vlerësuese që nxënësit/ et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Tabela 2: Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën teknika dhe proceset artistike

Rezultat i të nxënit	*Veprimtari praktike*
Përzgjedh dhe përdor teknika të ndryshme të stampimit për të realizuar idetë krijuese	Ora mësimore orientohet në përzgjedhjen dhe përdorimit të teknikës së stampimit në krijim. Gjithashtu një formë e orientimit është edhe ajo e përdorimit të stamipimit si një formë arti aplikativ, p.sh., stampimi i tekstileve (pëlhurave). Edhe këtu teknikat e stampimit aplikohen njësoj si mbi letër. Hapi I: ***Vëzhgim – "Cilat teknika stampimi ekzistojnë?" (***10 min). Nëpërmjet imazheve të ndryshme nxënësit/et diskutojnë: • mbi gjuhën specifike të realizimit të pëlhurave të stampuara; • mbi bojën specifike që përdoret në dekorimin e tyre;

- ngjashmërinë apo specifikat që kjo teknikë ka në krahasim me stampimin në letër.

	Hapi II: ***Ndërtimi i njohurive të reja dhe veprimtaria -****Krijim – "Realizo një ide me stampim"* (25 min). Mësuesi/ja shpjegon materislet tekstile si bazë për stampimin. Nëpërmjet imazheve nxënësit identifikojnë hapat që ndiqen në procesin e stampimit të pëlhurës. Mësuesi/ja orienton që për realizimin e stampimit të pëlhurës nxënësit mund të zgjedhin të përdorin teknikën me letër (stensil) ose atë me reliev. ***Veprimtari*** Nxënësit përzgjedhin motivin dhe krijojnë stampën për të realizuar dekorimin e pëlhurës së tyre. ***nxënësit*:** • Zgjedh 1 teknikë stampimi • Përdor elemente përsëritjeje ose modelimi • Krijon një mesazh ose ide vizuale • Prezanton procesin e punës

	Hapi III: ***Reflektimi*** (10 min): Reflektimi fokusohet: • në vlerësimin e procesit të punës dhe rezultatin e arritur; • në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.
Identifikon karakteristikat e fotografisë dixhitale dhe marrëdhënien e saj me fotografinë tradicionale	Ora mësimore orientohet në identifikimin e karakteristikave të fotografisë digjitale dhe asaj tradicionale dhe mundësitë shprehëse të tyre. Hapi I: ***Vëzhgim dhe dallim vizual (***10 min). Mësuesi drejton pyetje për diskutim në lidhje me: • aparatin fotografik dhe rëndësinë e fotografisë si një mjet për të ruajtur kujtime dhe ngjarje të ndryshme; • mbi opsionet që kanë aparatet e tyre fotografikë apo celularët për manipulimin e fotografive.

Hapi II: ***Ndërtimi i njohurive të reja dhe veprimtaria*** **- Analizë krahasuese (Punë në grupe)**

Nxënësit plotësojnë një tabelë krahasimi midis fotografisë tradicionale dhe asaj dixhitale. (25 min).

Mësuesi/ja shpjegon ndryshimin midis aparatit fotgrafik digjital dhe atij tradicional, në lidhje me mënyrën e funksionimit dhe lehtësinë për të transferuar imazhin digjital. Mësuesi/ja shpjegon:

	• pjesët përbërëse të aparatit fotografik digjital, • rolin që luajnë në krahasim me ato të aparatit tradicional, • përparësitë e fotografisë digjitale në krahasim me atë tradicionale Mësuesei shfaq vepra arti të realizuara me fotmontazh dhe fotokolazh për t'i kuptuar ato si një formë e shprehjes në art. ***Veprimtari - Krijim dhe reflektim*** Nxënësit krijojnë një mini-prezantim ose poster: "Evolucioni i fotografisë: nga film në dixhital" Nxënësit orientohen dhe nxiten të krijojnë edhe ata në këtë teknikë, duke u përpjekur të përcjellin një frymë ironie, humori apo edhe një lloj proteste ndaj fenomeneve. Ata mund të realizojnë një fotokolazh me mjete tradicionale ose nëpërmjet mjeteve digjitale (kompjuter, celular ose tabletë).

Hapi III: ***Reflektimi*** (10 min):

Reflektimi fokusohet:

- në dikutimin e karakteristikave të veçanta dhe të përbashkëta të fotografisë digjitale dhe asaj tradicionale.
- në mënyrën e realizimit dhe mundësitë e shumta shprehëse të fotografisë në realizimin e shumë ideve krijuese.

Identifikon përdorimin e gjuhës pamore në dizajn dhe rëndësinë e saj në komunikimin e idesë	Ora mësimore orientohet drejt krijimit në dizajn, projektit artistik dhe rëndësinë e përdorimit në gjuhës pamore në komunikimin e idesë. Hapi I: ***Vëzhgim – "Si flet dizajni pa fjalë?"*** *(*10 min). Nxënësit vëzhgojnë shembuj të ndryshëm dizajni dhe identifikojnë elementet e gjuhës pamore (ngjyra, forma, tipografia, simbolet).


25%
LOREM IPSUM
DOLOR SIT

01
Artistic
Design
Concepts
Bold
Creations
Emerge

create.
inspire
ESIGN

	Hapi II: ***Ndërtimi i njohurive të reja dhe veprimtaria - Analizë – "Si ndërtohet komunikimi vizual?"*** (25 min). Mësuesi/ja shpjegon : Si ndikon ngjyra në mesazhin e dizajnit? Pse disa dizajne kuptohen më shpejt se të tjerët? Çfarë roli ka renditja (hierarkia vizuale)? Mësuesi/ja shpjegon : konceptin dhe orientimin e punës së dizajnit grafik: • profesionistë që realizojnë projekte, të cilat kanë lidhje me forma të ndryshme të komunikimit pamor; • puna e tyre konsiston në krijimin e simboleve, shenjave, markave dhe logove. Mësuesi/ja nëpërmjet shembujve shpjegon se: • marka është një shenjë ose simbol grafik që ka një funksion të qartë, atë të identifikimit të menjëhershëm. ***Nxënësit analizojnë si elementet e dizajnit krijojnë kuptim dhe ndikojnë në perceptim.*** ***Veprimtaria krijuese - Krijim – "Dizajno mesazhin tënd"***

	Nxënësit krijojnë një poster të thjeshtë që komunikon një ide vetëm me gjuhë pamore (pa ose me shumë pak tekst). Ose Nxënësit nxiten të krijojnë një logo duke pasur parasysh elementet që e bëjnë atë të suksesshme në komunikimin e idesë. Hapi III: ***Reflektimi*** (10 min): Reflektimi fokusohet: • në diskutimin për logon apo simbolin grafik që krijuan. • në shpjegimin e hapave që ndoqën dhe qëllimin e krijimit. • grafik dizajni si si një mundësi karriere.

Tabela 3: Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën historia, arti dhe shoqëria

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike*
Përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson vepra arti, në kontekstin historik dhe në kontekstin social kulturor	Mësuesi orienton orën mësimore drejt analizës dhe vlerësimit të veprës në këndvështrimin dhe kontekstin historik. Hapi I. ***Përshkrim – "Çfarë shohim në vepër?"*** **(**10 min) Mësuesi orienton nxënësit të kujtojnë katër hapat që ndjekin kritikët e artit për të lexuar një vepër arti dhe shtron pyetjen: • A duhet studiuar vepra edhe në këndvështrimin historik? • A mund të ndërthuren të dyja si kritika e artit ashtu edhe kënvështrimi historik për të lexuar një vepër arti? Nxënësit vëzhgojnë vepra arti nga periudha të ndryshme dhe përshkruajnë elementet vizuale (figura, kompozimi, ngjyra, tema).

Hapi II: ***Ndërtimi i njohurive të reja - Analizë dhe interpretim – "Çfarë tregon vepra?"*** (25 min)

Mësuesi/ja shpjegon se Historia e artit shton njohuri të tjera nga ato që ne nxjerrim gjatë kritikës. Ashtu si në kritikën e artit, edhe në historinë e artit mund të ndjekim të njëjtën strategji dhe të njëjtët hapa gjatë kërkimit:

- Përshkrimi: Zbulojmë kur, ku dhe nga kush është krijuar vepra e artit.
- Analiza: Zbulojmë stilin unik të veprës.
- Interpretimi: Zbulojmë se si artistët ndikohen nga realiteti që i rrethon.
- Gjykimi: Marrim një vendim rreth rëndësisë së veprës në historinë e artit.

	Mësuesi/ja shpjegon si ndërthuret *Historia e artit* me *Kritikën e artit* gjatë studimit të veprës hap pas hapi Më pas nxënësit/et me orientimin e mësuesit/ses përdorin hapat e historisë së artit për të lexuar një vepër arti. Hapi III: ***Reflektimi - Vlerësim – "Si e gjykojmë veprën?"*** (10 min) Nxënësit diskutojnë dhe vlerësojnë veprën në aspektin artistik dhe kulturor. • A është vepra e suksesshme artistikisht? Pse? • Çfarë vlere ka në kulturën e kohës së saj? • Si ndikon në shoqërinë e sotme? Reflektimi orientohet: • në diskutimet mbi përdorimin e hapave të kritikës së artit të lidhura me këndvështrimin dhe kontekstin historik; • në përdorimin e hapave të kritikës së artit dhe historisë gjatë leximit të veprës së artit.
Identifikon veprat e artit dhe zhvillimet artistike në lidhje me periudhën historike dhe vendin;	Mësuesi përcakton periudhën artistike, duke u bazuar te programi dhe orienton orën mësimore në identifikimin e autorëve, veprave dhe karakteristikave të periudhës psh: Tema: Postimpresionizmi. Hapi I: ***Vëzhgim – "Cilat janë veprat e postimpresionizmit?*** (10 min) Nëpërmjet imazheve të pikturës së Van Gogut, Gogenit dhe Sezanit mësuesi nxit dhe orienton diskutimin:

	• Çfarë vëreni në këto vepra (ngjyra, forma, penelata)? • A janë reale apo më shumë shprehëse? • Cilat duken më të ndikuara nga emocionet? Qëllimi: identifikimi i stilit postimpresionist. 

Hapi II: ***Ndërtimi i njohurive të reja - Analizë – "Ku dhe kur u zhvillua Postimpresionizmi?"*** (25 min)

Mësuesi/ja shpjegon se artistët postimpresionist

- ishin një vazhdimi natyrshëm i impresionizmit.

Fokusi përqëndrohet te karakteristikat e veprave të:

- Sezanit
- Van Gogut,
- Gogeni

Mësuesi/ja shpjegon që Post impresionizmi gjeti pak ose aspak formë shprehjeje në skulptorët e kohës.

	Mësuesi/ja zgjedh një vepër përfaqësuese dhe orienton nxënësit të bëjnë "leximin e saj" duke ndjekur hapat e analizës së kritikës së artit. Hapi III: ***Reflektimi* - Interpretim dhe lidhje – "Çfarë solli Post impresionizmi?"** (10 min.): Reflektimi fokusohet: • në karakteristikat e "post impresionizmit" • autorët përfaqësues dhe karakteristikat e veçanta • kontekstin historik të periudhës Nxënësit interpretojnë rëndësinë e lëvizjes dhe ndikimin e saj në artin modern.
Përshkruan karakteristikat dalluese të veprave të artit në periudha historike dhe në kontekste kulturore të ndryshme	Mësuesi përcakton periudhën artistike, duke u bazuar te programi dhe orienton mësimin në identifikimin e veprave të artit dhe artistëve brenda kontekstit kulturor e historik – p.sh.: Tema: Arti figurativ shqiptar në periudhën e socializmit Hapi I: ***Vëzhgim – "Si duket arti i Realizmit Socialist?"*** (10 min.) Mësuesi nëpërmjet pyetjeve orienton nxënësit të diskutojnë mbi ndryshimet që ndodhën në vendin tonë mbas luftës së dytë botërore. Ata mbështeten në njohuritë që kanë marrë në lëndën e historisë për të diskutuar: • për zhvillimet politike; • ekonomike dhe shoqërore të kësaj periudhe;

	• Gjithashtu ata përmendin vepra dhe autorë shqiptarë të periudhës së socializmit të njohur për ta. Nxënësit vëzhgojnë vepra tipike të Realizmit Socialist dhe identifikojnë elementet vizuale dhe tematike. Çfarë personazhesh shfaqen më shpesh (punëtorë, ushtarë, fermerë)? • Si paraqiten ata (heroikë, të fortë, idealizuar)?

	• Çfarë temash vëreni (punë, industri, shtet, kolektivitet)? Qëllimi: identifikimi i karakteristikave vizuale. Hapi II: ***Ndërtimi i njohurive të reja*** - Analizë – "Çfarë mesazhi përcjell ky art? (25 min) Mësuesi/ja shpjegon se: • Pas Luftës së Dytë Botërore çdo sferë e jetës u vu nën ndikimin politik dhe ideologjik të partisë komuniste që doli fituese nga lufta; • Arti nuk mund të bënte përjashtim nga kjo. Si rrjedhojë çdo artist u kthye në propagandues të linjës zyrtare të partisë-shtet.

	Në çështjen e parë trajtohen: • Vitet e para të pasluftës dhe ndërtimi i institucioneve të artit, vitet ’50-’60; • Shteti sanksionoi vijën që duhet të ndiqte arti; • Shumë artistë të shkolluar në Perëndim u angazhuan në ilustrimin e një arti politik. Në çështjen e dytë trajtohen: • Vitet e liberalizmit dhe pranvera e artit shqiptar; • Çështje e diskutimit janë artistët përfaqësues me veprat e tyre; Në çështjen e tretë: • Metoda e realizmit socialist, piktura dhe skulptura monumentale; • Realizmi socialist funksionoi i bazuar në tematika të qarta. Çështje të diskutimit janë tematika e pasqyruar në veprat e artit, artistët përfaqësues dhe disa nga veprat e tyre më të njohura. Mësuesi/ja zgjedh një vepër përfaqësuese dhe orienton nxënësit të bëjnë “leximin e saj” duke ndjekur hapat e analizës së kritikës së artit brenda kontekstit historik dhe kulturor. Nxënësit analizojnë lidhjen midis artit dhe kontekstit historik-politik të Shqipërisë gjatë periudhës socialiste. ***Interpretim dhe krahasim – “Si ndryshon nga arti i lirë?”***

	Nxënësit krahasojnë Realizmin Socialist me periudha të tjera artistike dhe vlerësojnë karakteristikat dalluese. • Çfarë e dallon Realizmin Socialist nga arti modern? • A ka liri krijuese në këtë stil? • Si ndikon konteksti kulturor dhe politik në art? Hapi III: ***Reflektimi*** (10 min.): Reflektimi fokusohet: • në argumentet e trajtuara gjatë mësimit. • në karakteristikat e artit të realizmit socialist në Shqipëri • në autorët dhe veprat përfaqësuese

LËNDA: TEATËR

Tabela 1: Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën gjuha dhe komunikimi

Rezultat i të nxënit	*Veprimtari praktike*
Nxënësi përdor gjuhën teatrore për të shprehur emocione, mendime dhe situata jetësore përmes dialogut, lëvizjes dhe interpretimit skenik.	Krijimi dhe interpretimi i një situate teatrore ***Hapi I. Zbulimi i emocionit dhe komunikimit skenik (10–15 minuta)*** Veprimtaria nis me një atmosferë loje dhe bashkëpunimi për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë se komunikimi teatror realizohet jo vetëm me fjalë, por edhe me trupin, mimikën dhe emocionin. Mësuesi organizon lojën teatrore "Pasqyra emocionale". Dy nxënës dalin përpara klasës: njëri realizon një emocion vetëm me mimikë, gjeste dhe lëvizje trupore, ndërsa tjetri e imiton si pasqyrë. Loja vazhdon me emocione të ndryshme si: gëzim, habi, zemërim, frikë apo trishtim. Gjatë lojës, pjesa tjetër e klasës vëzhgon dhe përpiqet të identifikojë emocionin që interpretohet. Kjo i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e komunikimit joverbal në teatër. Më pas, mësuesi drejton pyetje nxënësve: • A mund të kuptojmë një emocion pa përdorur fjalë? • Çfarë ju ndihmoi më shumë për të kuptuar personazhin? • Si ndryshon kuptimi i një veprimi sipas mimikës apo tonit të zërit? • Pse është i rëndësishëm bashkëpunimi mes aktorëve në skenë? Në vijim, mësuesi prezanton shkurt elementet kryesore të komunikimit teatror:

	• 🎭 mimika dhe shprehja e fytyrës; • 🗣️ zëri, ritmi dhe intonacioni; • 🚶 lëvizja skenike dhe qëndrimi trupor; • 🤝 bashkëveprimi mes personazheve; • 👀 kontakti me publikun. Për ta bërë më konkrete veprimtarinë, mësuesi interpreton të njëjtën fjali me emocione të ndryshme, p.sh.: “Nuk e prisja këtë.” • me habi; • me zemërim; • me frikë; • me gëzim. Nxënësit diskutojnë se si ndryshon kuptimi i fjalisë sipas mënyrës së interpretimit. ☺ ➜ Gëzim 😳 ➜ Trishtim 😡 ➜ Zemërim 😳 ➜ Habitje 😨 ➜ Frikë

	🎭 Emocioni + 🧠 zëri + 🚶 lëvizja = Interpretim teatror **Hapi II. Krijimi i situatës teatrore (20–25 minuta)** Nxënësit ndahen në grupe me 4–5 veta. Çdo grup zgjedh ose tërheq me short një situatë të përditshme që do ta shndërrojë në etyd teatral. Mësuesi u shpjegon se etydi është një interpretim i shkurtër ku aktorët shprehin një situatë, konflikt ose emocion. Situatat mund të jenë: • një debat mes shokësh; • një ditë e vështirë në shkollë; • një konflikt familjar; • një festë surprizë; • një keqkuptim mes miqsh. Çdo grup organizon rolet dhe ndërton dialogun. Nxënësit udhëzohen të mendojnë: • si ecën personazhi; • si flet; • çfarë emocionesh shpreh; • si reagon ndaj personazheve të tjerë. Mësuesi i nxit të përdorin elemente simbolike dhe objekte të thjeshta skenike:

	një karrige si bankë shkolle; 📖 një libër si simbol i dijes; 🎒 një çantë për të krijuar atmosferën e shkollës. Gjatë punës në grup, mësuesi lëviz mes nxënësve, i ndihmon me ide dhe i orienton për përdorimin e hapësirës skenike dhe interpretimit emocional. ***Hapi III. Prezantimi dhe reflektimi (10 minuta)*** Grupet interpretojnë etydet përpara klasës. Nxënësit që ndjekin prezantimet mbajnë shënime të shkurtra mbi emocionet, dialogun dhe komunikimin skenik që vërejnë gjatë interpretimit. Pas çdo interpretimi, zhvillohet një reflektim i shkurtër në klasë. Mësuesi drejton pyetje si: • Cili personazh ju bëri më shumë përshtypje dhe pse? • Si u përdor zëri dhe lëvizja në skenë? • Çfarë emocionesh përcolli grupi? • Si ndikoi bashkëpunimi në interpretim? • Çfarë do të shtonit ose ndryshonit në këtë skenë? Në fund, mësuesi vlerëson çdo grup, duke evidentuar elemente të ndryshme si interpretimi më emocional, përdorimi më i mirë i zërit, bashkëpunimi më i mirë në grup dhe dialogu më krijues.

Nxënësi shpjegon parimet e krijimit të karakterit dhe elementet skenike që lidhen me plotësimin e figurës teatrore.	Krijimi i karakterit teatror ***Hapi I. Zbulimi i karakterit dhe tipareve të personazhit (10–15 minuta)*** Veprimtaria nis me një diskutim të shkurtër rreth personazheve të njohur nga teatri, filmat apo letërsia. Mësuesi u shfaq nxënësve disa imazhe ose përshkrime të personazheve të ndryshëm, si p.sh.: 🎩 një mbret krenar; 🤡 një personazh komik; 🦹 një detektiv misterioz; 😶 një gjyshe e dashur. Mësuesi u drejton pyetje nxënësve: • Si e kuptoni karakterin e personazhit vetëm nga pamja apo qëndrimi? • Çfarë e bën një personazh interesant? • Si ndikon mënyra e ecjes, zëri apo veshja në krijimin e figurës? Në vijim, mësuesi prezanton elementet kryesore të ndërtimit të karakterit teatral: 🎭 mimika dhe emocionet; 🗣️ mënyra e të folurit; 🚶 ecja dhe qëndrimi trupor;

	👗 kostumi dhe elementet skenike; ❗ sjellja dhe reagimi ndaj situatave. Për ta konkretizuar, mësuesi interpreton të njëjtën fjali në role të ndryshme, p.sh.: “Kush trokiti në derë?” • si një mbret autoritar; • si një personazh i frikësuar; • si një personazh komik. Nxënësit diskutojnë se si ndryshon karakteri përmes zërit, mimikës dhe lëvizjes. Të gjitha së bashku krijojnë karakterin teatror ***Hapi II. Ndërtimi dhe interpretimi i karakterit (20–25 minuta)*** Nxënësit ndahen në grupe me 4–5 veta. Çdo grup zgjedh ose tërheq me short një karakter të caktuar teatral. Shembuj karakteresh: • një mësues shumë i rreptë; • një nxënës i turpshëm; • një artist i famshëm; • një personazh komik; • një udhëheqës trim.

	Çdo grup punon për të ndërtuar figurën e personazhit duke përcaktuar: • si flet personazhi; • si ecën; • si reagon ndaj të tjerëve; • çfarë emocionesh shfaq më shpesh; • çfarë objektesh apo elementesh skenike mund ta plotësojnë figurën. Nxënësit krijojnë një situatë të shkurtër teatrore ku personazhi i tyre vihet në qendër të ngjarjes. Ata mund të përdorin objekte simbolike për të ndërtuar figurën: 🎩 kapelë për personazh autoritar; 📚 libra për një mësues; 🪄 bastun për një të moshuar; 🎨 penel ose fletore për artistin. Mësuesi i ndihmon nxënësit të përdorin hapësirën skenike dhe të kujdesen për interpretimin emocional dhe bashkëpunimin në grup. *Hapi III. Prezantimi dhe reflektimi (10 minuta)* Grupet interpretojnë personazhet e krijuar përpara klasës. Nxënësit e tjerë vëzhgojnë me kujdes mënyrën se si është ndërtuar karakteri dhe evidentojnë elementet më të spikatura të interpretimit.

	Pas çdo prezantimi, mësuesi zhvillon një diskutim reflektues me pyetje si: • Çfarë e bëri personazhin të besueshëm? • Si ndikuan zëri dhe lëvizja në krijimin e figurës? • Cilat elemente skenike ndihmuan më shumë? • Si ndryshonte ky personazh nga personazhet e tjera? Në fund, mësuesi vlerëson krijimtarinë dhe interpretimin e secilit grup, duke evidentuar elemente si karakteri më origjinal, interpretimi më emocional dhe bashkëpunimi më i mirë në grup.
Nxënësi evidenton elementet tipike kombëtare dhe ato universale në një pjesë dramaturgjike shqiptare ose botërore	Elementet kombëtare dhe universale në teatër ***Hapi I. Vëzhgimi dhe diskutimi i elementeve teatrore (10–15 minuta)*** Veprimtaria nis me paraqitjen nga mësuesi të disa fragmenteve të shkurtra nga pjesë teatrore shqiptare dhe botërore ose me imazhe/video nga shfaqje të ndryshme teatrore. Mësuesi mund të përdorë shembuj me kostume popullore shqiptare, muzikë tradicionale, dialogë karakteristikë apo elemente universale si familja, dashuria, konflikti dhe miqësia. Mësuesi drejton pyetje nxënësve: • Çfarë elementesh ju duken shqiptare në këtë pjesë teatrore? • Cilat tema mendoni se kuptohen nga njerëzit në çdo vend të botës? • Si ndikon kultura në mënyrën e interpretimit të personazheve?

	• Pse disa tema teatrore mbeten aktuale në çdo kohë? Në vijim, mësuesi shpjegon shkurt dallimin mes: • elementeve kombëtare (veshje, zakone, gjuhë, tradita, muzikë); • elementeve universale (emocione, marrëdhënie njerëzore, konflikte, ëndrra, frikëra). ***Hapi II. Analiza dhe krijimi i një skene teatrore (20–25 minuta)*** Nxënësit ndahen në grupe me 4–5 veta. Çdo grup merr një situatë ose fragment të shkurtër dramaturgjik dhe ka për detyrë të evidentojë elementet kombëtare dhe universale që përmban. Shembuj situatash: • një festë familjare tradicionale; • një konflikt mes brezave;

	• një histori miqësie; • një largim apo rikthim në atdhe; • një situatë bashkëpunimi mes shokësh. Çdo grup punon në dy faza: • identifikon elementet kombëtare dhe universale; • krijon një etyd të shkurtër teatral ku këto elemente të jenë të dukshme. Nxënësit udhëzohen të përdorin: 👗 elemente simbolike të kostumit; 🎶 muzikë tradicionale ose moderne; 🗣️ shprehje karakteristike gjuhësore; 🎭 emocione dhe konflikte të kuptueshme për çdo publik. Mësuesi i ndihmon nxënësit të kuptojnë se një vepër teatrore mund të jetë thellësisht shqiptare në formë, por njëkohësisht universale në mesazh. ***Hapi III. Prezantimi dhe reflektimi (10 minuta)*** Grupet interpretojnë etydet e tyre përpara klasës. Gjatë prezantimit, nxënësit e tjerë mbajnë shënime të shkurtra mbi elementet kombëtare dhe universale që identifikojnë në secilën skenë.

	Pas çdo interpretimi, mësuesi zhvillon një diskutim reflektues me pyetje si: • Cilat elemente ju dukën tipike shqiptare? • Cilat emocione apo tema ishin universale? • Si ndikoi kultura në ndërtimin e personazheve? • A mund të kuptohej kjo skenë edhe nga një publik i huaj? Pse? Në fund, mësuesi vlerëson punën e grupeve duke evidentuar, përdorimin më të mirë të elementeve kombëtare, interpretimin emocional, argumentimin më të qartë dhe bashkëpunimin më të mirë në grup.

Tabela 2:Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën teknika dhe procese

Rezultat i të nxënit	*Veprimtari praktike*
Nxënësi interpreton në mënyrë individuale dhe në ansambël, duke ndërtuar marrëdhënie skenike dhe duke respektuar rolin e tij brenda një shfaqjeje të thjeshtë teatrore.	Loja në ansambël dhe ndërtimi i marrëdhënieve skenike ***Hapi I. Aktivizimi dhe krijimi i atmosferës skenike (10–15 minuta)*** Veprimtaria nis me një ushtrim të thjeshtë për "dëgjimin skenik". Nxënësit qëndrojnë në rreth dhe mësuesi udhëzon një lojë ku një nxënës fillon një veprim të thjeshtë (p.sh. troket në ajër, hap një derë imagjinare, jep një mesazh me gjest), ndërsa të tjerët duhet ta vazhdojnë pa e prishur rrjedhën. Mësuesi u drejton pyetje nxënësve:

	• A e dëgjuat dhe e kuptuat veprimin e shokut? • Si u përshtatët me të? • Pse është e rëndësishme vëmendja në skenë? Qëllimi i këtij hapi është të kuptohet se teatri kërkon vëmendje, dëgjim dhe reagim të menjëhershëm ndaj partnerit skenik. ***Hapi II. Krijimi i etydit në ansambël (20–25 minuta)*** Nxënësit ndahen në grupe me 4–6 veta. Çdo grup merr një situatë të thjeshtë skenike dhe detyrën për ta kthyer në një etyd teatral ku secili ka rol të qartë dhe marrëdhënie me të tjerët. Shembuj situatash: • një ditë në klasë me një problem të papritur; • një planifikim për një festë; • një keqkuptim mes shokësh; • një udhëtim imagjinar. Çdo nxënës: 🎭 zgjedh ose i caktohet një rol;

	🗣️ krijon mënyrën e të folurit të personazhit; 🚶 përcakton lëvizjet skenike; 🤝 ndërton marrëdhënie me partnerët në skenë. Mësuesi i udhëzon që askush të mos “dominojë” skenën, por të ruhet ekuilibri i lojës në ansambël. Nxënësit inkurajohen të improvizojnë dialog dhe reagime në mënyrë spontane. ***Hapi III. Prezantimi dhe reflektimi (10 minuta)*** Grupet interpretojnë etydet e tyre përpara klasës. Nxënësit që vëzhgojnë mbajnë shënime të shkurtra mbi: • bashkëpunimin në grup; • dëgjimin mes aktorëve; • ndërtimin e marrëdhënieve skenike; • ruajtjen e ritmit të skenës. Pas çdo interpretimi, mësuesi drejton pyetje reflektuese: • Si bashkëpunoi grupi në skenë? • A u dëgjuan dhe u respektuan të gjithë aktorët? • Cili moment ishte më i suksesshëm në ansambël?

	• Çfarë do të përmirësonit në interpretim? Në fund, mësuesi vlerëson punën duke theksuar bashkëpunimin në grup, dëgjimin skenik, improvizimin kreativ dhe ruajtjen e ritmit dhe harmonisë së skenës.
Nxënësi improvizon lirshëm gjatë etydeve skenike duke sjellë krijimtari dhe duke përdorur nëntekstin në interpretim.	Improvizimi dhe nënteksti në interpretim teatror ***Hapi I. Zbulimi i nëntekstit përmes situatave të thjeshta (10–15 minuta)*** Veprimtaria nis me një ushtrim të shkurtër ku mësuesi thotë disa fjali të thjeshta që mund të thuhen me kuptime të ndryshme. Nxënësit i lexojnë dhe i interpretojnë në mënyra të ndryshme: Shembuj: • "Erdhe më në fund." • "Nuk e di." • "Shumë mirë." Mësuesi u kërkon nxënësve ta thonë të njëjtën fjali: 🎭 si i lumtur; 😩 si i zemëruar; 😒 si i trishtuar; 😏 me ironi.

	Pyetje për nxënësit: • A ndryshon kuptimi i fjalisë sipas mënyrës së thënies? • Çfarë është “ajo që nuk thuhet me fjalë”? • Si e kuptojmë nëntekstin në teatër? Mësuesi shpjegon shkurt se nënteksti është kuptimi i fshehur pas fjalëve, që shprehet përmes zërit, mimikës dhe sjelljes. ***Hapi II. Krijimi i etydit improvizues në grupe (20–25 minuta)*** Nxënësit ndahen në grupe me 4–5 veta. Çdo grup merr një situatë të thjeshtë dhe e zhvillon si etyd improvizues, duke u fokusuar te nënteksti dhe reagimet spontane. Shembuj situatash: • një surprizë që nuk shkon siç pritej; • një keqkuptim mes shokësh; • një takim i papritur; • një lajm i rëndësishëm në klasë. Detyrat e nxënësve: 🎭 të mos mësojnë dialog fiks, por të improvizojnë;

	të përdorin tonin e zërit për të ndryshuar kuptimin; të shprehin emocione përmes trupit; të krijojnë nëntekst (ajo që personazhi mendon, por nuk e thotë hapur). Mësuesi i udhëzon që çdo skenë të ketë një "kuptim të fshehur", p.sh.: • fjalët thonë "jam mirë", por trupi tregon të kundërtën; • buzëqeshje e jashtme, por zemërim i brendshëm; • mirësjellje, por rivalitet i fshehur. ***Hapi III. Prezantimi dhe reflektimi (10 minuta)*** Grupet interpretojnë etydet improvizuese përpara klasës. Nxënësit vëzhgues përpiqen të zbulojnë nëntekstin e çdo skene. Mësuesi drejton pyetje reflektuese: • Çfarë mendoni se ndiente personazhi në të vërtetë? • A ishte ndryshe ajo që tha nga ajo që shprehu me trup? • Si e kuptuat nëntekstin? • Cila skenë ishte më e besueshme dhe pse?

	Në fund, mësuesi vlerëson nxënësit për improvizimin më kreativ, përdorimin më të mirë të nëntekstit, bashkëpunimin në grup dhe interpretimin më të natyrshëm skenik.
Nxënësi interpreton në ansambël duke bashkëpunuar me të tjerët dhe duke respektuar rolin e tij në skenë.	Loja në ansambël – "Një skenë e përbashkët" ***Hapi I. Ngrohja dhe përgatitja për punë në grup (10–15 minuta)*** Veprimtaria nis me një lojë të thjeshtë lëvizjeje në klasë për të krijuar vëmendje dhe bashkëpunim. Nxënësit lëvizin lirshëm në hapësirën e klasës dhe mësuesi jep komanda të shkurtra si: • ndal; • ec ngadalë; • ndrysho drejtim; • krijo grup me 3 shokë; • ngrije dorën si sinjal. Qëllimi është që nxënësit të mësojnë të jenë të vëmendshëm ndaj të tjerëve dhe të reagojnë shpejt si grup. Mësuesi ju drejton pyetje nxënësve: • A ishte e lehtë të lëviznit si grup? • Pse është e rëndësishme të dëgjojmë njëri-tjetrin në skenë? ***Hapi II. Krijimi i skenës së thjeshtë në grup (20–25 minuta)***

	Nxënësit ndahen në grupe me 4–5 veta. Çdo grup krijon një skenë të shkurtër nga jeta e përditshme, si p.sh.: • në klasë; • në pushim; • në një festë; • në një situatë loje. Çdo nxënës merr një rol të thjeshtë dhe të barabartë në skenë. Ata duhet të: 🎭 luajnë rolin e tyre pa dominuar skenën; 🗣️ flasin dhe reagojnë me njëri-tjetrin; 🤝 bashkëpunojnë në veprimet skenike; 🚶 përdorin hapësirën e klasës si skenë. Mësuesi i udhëzon që të mos punojnë veçmas, por si një "ekip aktorësh" ku secili ndihmon tjetrin. ***Hapi III. Prezantimi dhe reflektimi (10 minuta)*** Grupet interpretojnë skenat përpara klasës. Nxënësit që vëzhgojnë shikojnë: • a bashkëpunuan aktorët; • a u dëgjuan njëri-tjetrin; • si u nda hapësira skenike;

	• a u kuptua historia. Mësuesi drejton pyetje reflektuese: • A punoi grupi si një i vetëm? • Kush ndihmoi më shumë në skenë? • A kishte bashkëpunim mes personazheve? Në fund, mësuesi vlerëson nxënësit për bashkëpunimin në grup, dëgjimin dhe respektimin e roleve dhe interpretimin e thjeshtë dhe të qartë.

Tabela 3: Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën historia, teatri dhe shoqëria

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike*
Nxënësi analizon zhvillimin e dramaturgjisë shqiptare në periudha të ndryshme duke evidentuar karakteristikat historike, shoqërore dhe artistike të saj.	Teatri shqiptar në kohë – nga tradita te moderniteti **Hapi I. Zbulimi dhe orientimi historik (10–15 minuta)** Veprimtaria nis me një prezantim vizual nga mësuesi (foto, postera, ose fragmente të shkurtra video) që paraqesin periudha të ndryshme të teatrit shqiptar: 🎭 teatër me motive historike/tradicionale; 🎭 teatër i periudhës së realizmit socialist; 🎭 teatër modern/bashkëkohor. Mësuesi u drejton pyetje nxënësve: • Çfarë vini re në kostume dhe skenografi? • Si ndryshojnë temat nga një periudhë në tjetrën? • Çfarë emocionesh ose mesazhesh përcjell secila skenë? • Si lidhet teatri me shoqërinë e kohës? Mësuesi shpjegon shkurt se teatri ndryshon sipas historisë, politikës dhe kulturës së çdo periudhe. **Hapi II. Punë në grupe – analiza e periudhave (20–25 minuta)**

	Nxënësit ndahen në 3–4 grupe. Çdo grup merr një periudhë të caktuar të teatrit shqiptar dhe punon si “ekip studiuesish teatrorë”. Periudhat: • Teatri tradicional dhe dramat historike; • Teatri i realizmit socialist; • Teatri bashkëkohor shqiptar; • Komedia shoqërore dhe drama moderne. Detyrat e grupit: 📚 të përmbledhin karakteristikat kryesore të periudhës; 🎭 të identifikojnë llojin e dramave dhe tematikat; 🧠 të shpjegojnë ndikimin e shoqërisë në teatër; 🗣️ të gjejnë një mesazh kryesor të veprave të asaj kohe; 📌 të përgatisin një prezantim të shkurtër (poster ose skemë në letër). Nxënësit mund të përdorin edhe elemente vizuale: 🖼 vizatime të skenës; ✍️ fjalë kyçe;

	🎭 simbole të periudhës; 📊 tabela krahasuese. **Hapi III. Prezantimi dhe krahasimi (10–15 minuta)** Çdo grup prezanton punën e tij përpara klasës. Nxënësit e tjerë mbajnë shënime dhe krahasojnë periudhat. Mësuesi drejton diskutim reflektues: • Cilat janë ndryshimet kryesore mes periudhave? • Si ndikon shoqëria në përmbajtjen e teatrit? • Cilat mesazhe janë universale dhe cilat janë specifike për kohën? • Çfarë elementi ju duk më interesant në teatrin shqiptar? Në fund mësuesi vlerëson nxënësit për analizën e saktë historike, bashkëpunimin në grup, prezantimin e qartë dhe lidhjen e teatrit me shoqërinë.
Nxënësi evidenton dhe krahason karakteristikat e zhanreve dhe stileve teatrore në periudha të ndryshme historike.	Zhanret dhe stilet teatrore në kohë të ndryshme **Hapi I. Zbulimi i zhanreve përmes shembujve (10–15 minuta)** Veprimtaria nis me paraqitjen nga mësuesi të disa situatave të shkurtra teatrore (të lexuara ose të interpretuara). Secila situatë përfaqëson një zhanër të ndryshëm: 🎭 tragjedi (konflikt serioz, emocione të forta) 😂 komedi (situata humoristike) ⚔️ dramë historike (ngjarje të së kaluarës)

	🥊 dramë shoqërore (probleme të jetës së përditshme) Mësuesi u drejton pyetje nxënësve: • Çfarë ndjeni gjatë këtij fragmenti? • A ju duket më shumë komedi apo dramë? Pse? • Çfarë e bën të ndryshme një tragjedi nga një komedi? **Hapi II. Punë në grupe – krahasimi i zhanreve (20–25 minuta)** Nxënësit ndahen në grupe me 4–5 veta. Çdo grup merr një zhanër dhe e analizon duke plotësuar një tabelë të thjeshtë krahasimi. Detyrat e nxënësve: 📌 të përshkruajnë karakteristikat e zhanrit; 🎭 të gjejnë një shembull situate; 🧠 të shpjegojnë emocionet që përcjell; 🏛️ të lidhin zhanrin me periudhën historike (antik, modern, bashkëkohor); 🤝 të diskutojnë me grupet e tjera për ngjashmëritë dhe ndryshimet. Mësuesi i orienton nxënësit të krijojnë një "hartë krahasuese" në letër, ku të analizojnë dhe krahasojnë zhanre të ndryshme artistike sipas karakteristikave, emocionit që përcjellin, shembujve përkatës dhe periudhës historike. Fillimisht, nxënësit zgjedhin zhanrin që do të trajtojnë. Më pas analizojnë tiparet kryesore të tij dhe identifikojnë elementet dalluese. Në vijim, ata e krahasojnë me zhanre të tjera për të evidentuar ngjashmëritë

	dhe ndryshimet. Pas analizës, plotësojnë tabelën krahasuese me të dhënat e mbledhura dhe në fund prezantojnë përfundimet e punës së tyre para klasës. **Hapi III. Prezantimi dhe reflektimi (10–15 minuta)** Grupet prezantojnë analizat e tyre para klasës dhe diskutojnë mbi dallimet ndërmjet zhanreve dhe stileve teatrore. Gjatë prezantimeve, nxënësit e tjerë ndërhyjnë me komente, krahasime dhe mendime shtesë, duke pasuruar diskutimin dhe duke reflektuar mbi veçoritë e secilit zhanër. Mësuesi drejton bisedën përmes pyetjeve reflektuese, duke i nxitur nxënësit të shprehin mendimet dhe argumentet e tyre mbi zhanrin që iu duk më i lehtë për t'u kuptuar, dallimet kryesore ndërmjet komedisë dhe tragjedisë, si edhe mënyrën se si ndryshon stili i një vepre nga një periudhë historike në tjetrën. Në përfundim të veprimtarisë, mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësve për të bërë krahasime, nivelin e analizës së zhanreve teatrore, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në grup, si edhe qartësinë dhe mënyrën e prezantimit të ideve.
Nxënësi lidh zhvillimin e teatrit me kontekstin historik dhe shoqëror, duke shpjeguar si ngjarjet e kohës ndikojnë në temat dhe mesazhet e veprave teatrore.	Teatri dhe shoqëria – si ndikon koha në art **Hapi I. Zbulimi i lidhjes teatër–shoqëri (10–15 minuta)** Veprimtaria nis me paraqitjen nga mësuesi të tre situatave të thjeshta historike/shoqërore dhe disa fragmenteve të shkurtra teatrore të lidhura me to: 🏛 periudhë lufte / konflikt shoqëror 🎭 teatër me temë heroizmi ose sakrifice

	🎇 periudhë paqeje / zhvillimi shoqëror 🎭 teatër me temë jetën e përditshme ⚙️ periudhë ndryshimesh sociale 🎭 teatër me temë kritikë shoqërore **Pyetjet e mësuesit për diskutim:** • Si ndryshojnë temat e shfaqjeve teatrale në periudha të ndryshme? • A e pasqyron teatri jetën reale? Në ç'mënyrë? • Pse artistët trajtojnë problemet e shoqërisë në veprat e tyre?


TEATRI DHE JETA
Një lidhje e vazhdueshme
1
SHOQËRIA DHE KOHA
Çdo periudhë historike, kultura, vlerat, ngjarjet dhe problemet e shoqërisë ndikojnë në krijimin e veprave teatrore.
2
TEMA E TEATRIT
Teatri trajton tema nga jeta reale, si: dashuria, familja, konfliktet, padrejtësia, liria, lufta, miqësia etj.
3
MESAZHI
Përmes ngjarjes, personazheve dhe dialogëve, vepra përcjell ide, emocione dhe mesazhe që nxisin mendimin dhe reflektimin e publikut.
4
PUBLIKU
Publiku e sheh, e kupton, e interpreton dhe e lidh mesazhin e veprës me jetën e tij të përditshme.
5
NDRYSHIMI DHE NDIKIMI
Teatri ndikon në mendimet, qëndrimet dhe sjelljen e njerëzve. Kështu, ai kthehet në shoqëri dhe ndihmon në një botë më të mirë.
TEATRI
është pasqyrë e shoqërisë dhe një mjet i fuqishëm për të kuptuar kohën dhe njeriun.
PYETJET E MËSUESIT PËR DISKUTIM
1. Çfarë ndryshon në temat e shfaqjeve sipas kohës?
2. A pasqyron teatri jetën reale? Si?
3. Pse artistët flasin për problemet e shoqërisë?
Teatri na bën të mendojmë, të ndiejmë dhe të ndryshojmë!

	Hapi II. Punë në grupe – analiza e lidhjes historike (20–25 minuta) Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup merr një periudhë historike: • Antikiteti • Mesjeta • Rilindja / Rilindja kombëtare • Teatri modern dhe bashkëkohor

TEATRI NËPËR PERIUDHA HISTORIKE
ARTI PASQYRON SHOQËRINË – TEATRI I JEP ZË REALITETIT
1. ANTIKITETI
2. MESJETA
3. RILINDJA / RILINDJA KOMBËTARE
4. TEATRI MODERN DHE BASHKËKOHOR
KUSHTET HISTORIKE DHE SHOQËRORE
Shoqëri qytetare, demokraci në Greqi. Festat fetare në nder të Dionisit.
Shoqëri feudale, e dominuar nga Kisha. Besimi fetar ndikonte çdo aspekt të jetës.
Ringjallje e kulturës dhe dijes. Njeriu vendoset në qendër të vëmendjes.
Shoqëri industriale, luftëra, kriza, ndryshime të mëdha shoqërore e teknologjike.
TEMAT KRYESORE TË TEATRIT
• Mytet dhe legjendat
• Fati i njeriut
• Konflikti midis njeriut dhe zotave
• Tema fetare (jeta e shenjtorëve)
• Lufta e së mirës kundër së keqes
• Moraliteti dhe mëkati
• Njeriu dhe ndjenjat e tij
• Dashuria, nderi, liria
• Atdheu, gjuha, identiteti kombëtar
• Problemet e individit modern
• Shoqëria, padrejtësia, lufta
• Identiteti, izolimi, ekzistenca
MESAZHI QË PËRCJELLIN VEPRAT
Jeta është e lidhur me fatin, por njeriu mban përgjegjësi për veprimet e tij.
Nxit besimin, pendimin dhe jetesën sipas vlerave fetare. E mira fiton mbi të keqen.
Njeriu ka vlera dhe aftësi të mëdha. Nevoja për arsim, liri dhe ndërgjegje kombëtare.
Nxit mendimin kritik, vë në pikëpyetje realitetin dhe kërkon ndryshim në shoqëri.
LIDHJA E ARTIT ME REALITETIN E SHOQËRISË
Teatri ishte pjesë e jetës publike dhe edukonte qytetarët përmes tragjedisë dhe komedisë.
Teatri kishte funksion edukues dhe fetar; pasqyronte mendësinë dhe besimet e kohës.
Teatri u bë mjet për zgjim kombëtar dhe për përhapjen e ideve humaniste.
Teatri pasqyron realitetin e vështirë të njeriut modern dhe sfidon mendësitë e vjetra.
SHEMBUJ TË VEPRAVE
Eshili – "Prometeu i lidhur"
Sofokliu – "Mbreti Edip"
Aristofani – komeditë
Drama liturgjike
Drama moraliteti
Mistëret mesjetare
Shekspir – "Hamleti"
Moliere – "Tartufi"
Vepra të rilindësve shqiptarë
Ibsen – "Një armik i popullit"
Beketi – "Në pritje të Godosë"
Dramaturgë bashkëkohorë
DETYRAT E GRUPIT
1. PËRSHKRUNI kushtet historike dhe shoqërore të periudhës.
2. IDENTIFIKONI temat kryesore të teatrit në atë kohë.
3. SHPJEGONI mesazhin që përcjellin veprat.
4. LIDHNI ARTIN me realitetin e shoqërisë.
5. KRIJONI një tabelë ose poster krahasues.
KRAHASONI!
ÇFARË NDRYSHON?
ÇFARË MBETET E NJEJTË?
ÇFARË NA BASHKON?

	Hapi III. Prezantimi dhe reflektimi (10–15 minuta) Grupet prezantojnë punimet e tyre para klasës, duke krahasuar mënyrën se si teatri ka ndryshuar nga një periudhë historike në tjetrën. Gjatë prezantimeve, nxënësit shpjegojnë dallimet në temat, stilin dhe funksionin e teatrit, duke treguar se si këto elemente lidhen me kohën dhe shoqërinë ku ai është zhvilluar. Mësuesi drejton një diskutim të hapur me klasën, duke i nxitur nxënësit të reflektojnë mbi disa pyetje thelbësore: si ndikon historia në formësimin e teatrit të një kohe të caktuar, nëse mesazhet që përcjell teatri mbeten të njëjta apo ndryshojnë me kalimin e kohës, dhe çfarë lidhjeje ka teatri me jetën e përditshme të njerëzve. Në përfundim të veprimtarisë, mësuesi vlerëson punën e nxënësve duke u bazuar në analizën e kontekstit historik, aftësinë për të lidhur teatrin me shoqërinë, bashkëpunimin në grup gjatë punës dhe qartësinë e prezantimeve të tyre.

LËNDA: MUZIKË

Tabela 1: Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën gjuha dhe komunikimi muzikor

Rezultat i të nxënit	*Veprimtari praktike*
Shpjegon funksionet e muzikës përgjatë historisë	E gjithë ora mësimore do të qartësojë pyetjen se: Pse është përdorur muzika në kohë të ndryshme? **Hapi I: Brainstorming (10 minuta)** Mësuesi për dëgjim vendos: • një pjesë gregoriane (muzikë kishtare) • një marsh ushtarak • një këngë moderne (p.sh. pop). Më pas ai drejton pyetjen: • "Ku mendoni se mund të përdorej kjo muzikë?" • "Çfarë qëllimi ka/kishte?" **Hapi II: Punë në grupe (25 minuta) Pro dhe kundër** Zhvillohet një veprimtari mësimore ku i ndan nxënësit në 3–4 grupe. Ai i udhëzon ata që secili grup të marrë një rast konkret:

	• Muzika në kishë. • Muzika në luftë (marsh). • Muzika në festa. • Muzika sot (rrjete sociale, filma). Për secilën nga grupet kërkohet që të: • Japin *2 funksione konkrete* për qëllimin mbi të cilën përdorej muzika në kohë të ndryshme (p.sh. bashkim njerëzish, motivim, argëtim) • Japin *një shembull real* (p.sh. himni kombëtar në ndeshje). • Japin shembuj konkretë, duke argumentuar edhe rëndësinë që ato kanë në jetën tonë: o "Marshi përdoret për të rritur moralin e ushtarëve" o "Muzika në rrjetet sociale përdoret për trend dhe ndikim emocional" Çdo lider i grupit prezanton punimin e grupit. **Hapi III: Reflektim (10 minuta) Diagrama e Venit** Mësuesi i drejton pyetjen nxënësve për të kuptuar sa ata janë në gjendje të flasin lidhur me temën mësimore të trajtuar. Pyetja mund të jetë: "A është muzika sot më shumë argëtim apo ndikim social?" kush janë të përbashkëtat dhe veçantat?

FUNKSIONET E MUZIKËS PËRGJATË HISTORISË

Analizë kritike me teknikën PRO & KUNDËR

FUSHA / KONTEKSTI	LUFTË Motivim, koordinim, propagandë	SPORT Motivim, ritëm, përmirësim i performancës	MJEKËSI Terapi, qetësim, shërim	EDUKIM Zhvillim kognitiv, emocional, social	FEJA & RITUALET Adhurim, spiritualitet, bashkim komuniteti	PUNË & JETË E PËRDITSHME Ritëm pune, argëtim, shoqërim
PRO PËRFITIME DHE FUNKSIONE POZITIVE	• Rrit moralin dhe motivimin e ushtarëve. • Koordinon lëvizjet dhe komunikimin në fushëbetejë. • Përdoret për propagandë kombëtare dhe unitet. • Ndihmon në përballimin e frikës dhe stresit.	• Rrit motivimin dhe energjinë. • Përmirëson performancën dhe ritmin. • Ndihmon në përqendrim dhe qëndrueshmëri. • Forcon emocionet pozitive dhe frymën ekipore.	• Ul stresin, ankthin dhe dhimbjen. • Ndihmon në rehabilitim fizik dhe mendor. • Përmirëson gjumin dhe gjendjen emocionale. • Përdoret në terapi për sëmundje të ndryshme.	• Zhvillon aftësitë njohëse dhe kreative. • Përmirëson kujtesën, vëmendjen dhe disiplinën. • Ndihmon në zhvillimin emocional dhe social. • Përfshin dhe motivon nxënësit.	• Krijon ndjesi të shenjtë dhe përkushtimi. • Bashkon komunitetin në rituale. • Përcjell mesazhe shpirtërore dhe morale. • Ruajtje e traditave dhe identitetit kulturor.	• Lehtëson punën e lodhshme me ritëm. • Argëton dhe relakson. • Forcon lidhjet shoqërore. • Përcjell emocione dhe shpreh kulturën e përditshme.
KUNDËR RREZIQE DHE ANE NEGATIVE	• Mund të nxisë dhunë dhe agresivitet. • Përdoret për manipulim dhe indoktrinim. • Glorifikon luftën dhe urrejtjen. • Shkakton trauma psikologjike (p.sh. këngë lufte).	• Mund të krijojë presion të tepruar. • Degjimi i muzikës me zë të lartë mund të dëmtojë degjimin. • Mund të shkaktojë varësi psikologjike.	• Jo e përshtatshme për të gjitha gjendjet (p.sh. trauma të rënda). • Mund të ngjallë kujtime të dhimbshme. • Përdorimi i gabuar mund të shkaktojë ankth.	• Mund të jetë shpërqendruese nëse përdoret pa kriter. • Rrezik i komercializimit të edukimit muzikor. • Jo çdo muzikë i përshtatet vlerave edukative.	• Mund të përdoret për përjashtim ose ndarje. • Formalizim i tepruar humb qëllimin shpirtëror. • Keqpërdorim për interesa personale ose politike.	• Muzika e zhurmshme mund të shkaktojë stres. • Mund të nxisë konsumizëm dhe varësi. • Përmbajtje e papërshtatshme mund të ndikojë negativisht në sjellje.
SHEMBUJ HISTORIKË	• Drumberët në ushtritë e lashta (Greqi, Romë). • Këngët patriotike në luftërat botërore. • Propaganda muzikore në regjime totalitare.	• Muzika në Olimpiadën e Lashtë. • Himnet sportive dhe këngët e tifozëve. • Muzika në stërvitje dhe gara moderne.	• Përdorimi i muzikës në spitalet e lashta. • Muzikoterapia nga Shek. XX (Nordoff-Robbins). • Përdorimi i muzikës në kujdesin paliativ.	• Metoda Orff, Kodály, Suzuki. • Muzika në shkollat antike dhe mesjetare. • Edukimi muzikor modern në kurrikula.	• Himnet gregoriane në Kishën Katolike. • Muzika sufi në ritualet islame. • Këngët tradicionale në ceremoni fetare.	• Këngët e punës në bujqësi dhe ndërtim. • Muzika popullore në festa dhe gëzime. • Muzika në transport, dyqane, ambiente publike.

REFLEKTIM

Pas analizës PRO & KUNDËR, krahasojmë funksionet e muzikës në këto fusha.

Çfarë ngjasimësh dhe ndryshimesh keni zbuluar?

Ku ka më shumë përfitime se rreziqe?

Si mund ta përdorim muzikën në mënyrë etike e të përgjegjshme?

DIAGRAMA E VENIT – NGJASHMËRI DHE NDRYSHIME



Argumenton gjykimin ndaj një vepre muzikore	**Hapi I: Brainstorming (10 minuta)** Mësuesi përgjatë orës do të ndërtojë aftësitë argumentuese lidhur me veprën/muzikën e parapëlqyer: p.sh. *A është kjo vepër "e mirë"? Pse?* Ai vendos për dëgjim (10 minuta) • Një këngë vokale (p.sh. baladë) • Një pjesë instrumentale (p.sh. klasike) **Hapi II (25 minuta):** Më pas ai kërkon që nxënësit të plotësojnë analizën e tyre në një fletë duke argumentuar arsyet pse e pëlqejnë ose jo veprën muzikore të dëgjuar. • Më pëlqeu sepse… • Nuk më pëlqeu sepse… • Elementi më i fortë ishte… (ritmi, melodia, zëri) Nxënësit orientohen të shkruajnë dhe të diskutojnë më pas duke artikuluar saktë dhe qartë mendimin e tyre si p.sh.: "Kjo pjesë është e mirë sepse ka një melodi të qartë dhe emocionale"…… ose "Nuk më pëlqen sepse ritmi është monoton" …….

	Të dyja grupet duhet të mbrojnë mendimet e kundërta për të njëjtën pjesë, duke artikuluar jo vetëm një mendim të qartë por edhe një fjalor të pasur muzikore. **Hapi III: Reflektim (10 minuta).** Mësuesi i drejton pyetjen nxënësve për të kuptuar sa ata janë në gjendje të flasin lidhur me temën mësimore të trajtuar. Pyetja mund të jetë: "A mund të themi që një vepër muzikore është e keqe dhe një e mirë? Pse?
Diskuton emocionet që krijon muzika	**Hapi I. Brainstorming (10 minuta)** Mësuesi kërkon që nxënësit të flasin për emocionet që krijon muzika dhe ndikimet e saj? Nxënësit hedhin ide të ndryshme të muzikës dhe ndikimit që krijon tek çdo individ. **Hapi II:** Mësuesi vendos për dëgjim fragmente të ndryshme muzikore: *Një pjesë muzikore të qetë (piano, violinë apo çdo lloj instrumenti tjetër).* *Një pjesë muzikore dinamike Simfonia 5 – Bethoven apo (rock/pop/tuist etj).* *Një pjesë muzikore (vals, popullore etj.).* Mësuesi kërkon nga nxënësit të reagojnë duke shkruajtur mendimet e tyre për secilën prej tyre shkurt: *"Ndjeva…"* *"Mendoj se kjo ndodh sepse…"* *"Kjo këngë më duket e trishtuar sepse ka tempo të ngadaltë dhe tonalitet minor"*

	Më pas ai pyet duke iu referuar karakteristikave të pjesëve që ata dëgjuan: • "Tempo e shpejtë → çfarë emocioni shkakton?" • "Zë i ulët → çfarë ndjesie ju krijon?" **Hapi III: Reflektim (10 minuta).** Mësuesi i drejton pyetjen nxënësve për të kuptuar sa ata janë në gjendje të flasin lidhur me temën mësimore të trajtuar. Pyetja mund të jetë: "A mund të themi që një vepër muzikore ndikon shumë emocionalisht tek ne? A mund të themi që muzika që dëgjojmë na pëlqen ose jo bazuar në ndjesinë tonë emocionale? Pse?
Bën dallimin e formave muzikore njëpjesëshe, dypjesëshe, tre pjesëshe vokale dhe instrumentale dhe polifonike gjatë dëgjimit muzikor (sonata).	**Hapi I: Brainstorming – pyetje nxitëse dëgjim aktiv(10 minuta)** Mësuesi vendos për dëgjim (10 minuta) një fragment nga vepra muzikore për piano në Do + (fillimi) e Moxart dhe nxit nxënësit të flasin rreth asaj që dëgjojnë dhe sa herë përsëritet fragmenti i ngjashëm. Dëgjimi ndihmon në nxitjen e interesit për dëgjim dhe kuptimin e strukturës së sonatës. **Hapi II (25 minuta) Zhvillim- zbulim dhe kuptim** Më pas mësuesi shpjegon formën e strukturës së sonatës ***ekspozita – zhvillimi – riprezantimi – koda .*** *Më pas* vendos për dëgjim një pjesë të dytë nga sonata patetike e Bethoven duke analizuar së bashku këtë vepër muzikore. Nxënësit orientohen të identifikojnë dhe të shkruajnë në një fletë strukturën e sonatës në mënyrë skematike dhe diskutojnë duke artikuluar saktë dhe qartë mendimin e tyre lidhur me sonatën.

	Të dyja grupet duhet të mbrojnë mendimet për sonata që kanë dëgjuar, duke artikuluar jo vetëm një mendim të qartë por edhe një fjalor të pasur muzikor. **Hapi III: Reflektim (10 minuta).** Nxënësit zgjedhin një vepër instrumentale duke prezantuar formën dhe strukturën e tyre. Çdo grup prezanton dhe reflekton mbi formën muzikore të mësuar se si kjo formë krijon kontrast në muzikë midis pjesëve .


1 NGJALLJA E INTERESIT – HYRJE
Teknika: Pyetje nxitëse, dëgjim aktiv
ÇFARË NDODH NË KËTË PJESË?
A
B
A'
Coda
• Dëgjojmë një fragment nga Mozart – Sonata për piano nr. 16 në Do major, K. 545 (fillimi).
• Pyetje nxitëse: Çfarë ndryshimesh dëgjoni? Sa herë kthehet tema kryesore?
• Nxënësit japin mendimet e tyre. Bashkë formulojmë idenë se muzika ka një "plan".
Qëllimi:
Të nxisim dëgjimin aktiv dhe të krijojmë kureshtje për strukturën e sonatës.
2 ZHVILLIMI – ZBULIMI DHE KUPTIMI
Teknika: Mësimdhënie e drejtuar + punë në çifte
FORMA E SONATËS (KLASIK(E))
EKSPOZITA
(A) Tema kryesore në tonikë
(B) Tema dytësore në dominatë
ZHVILLIMI
Zhvillim i motiveve, modulime, dialog tematik
RIPREZANTIMI
(A') Tema kryesore rikthehet në tonikë
(B') Tema dytësore në tonikë
CODA (përfundimi)
• Shpjegohet në mënyrë të strukturuar forma e sonatës: Ekspozita – Zhvillimi – Riprezantimi – Coda.
• Analizojmë së bashku një shembull të dytë (p.sh. Beethoven – Sonata "Patetike", Op. 13).
• Nxënësit, në çifte, identifikojnë pjesët e formës në një skemë të thjeshtë (fletë pune).
Qëllimi:
Të kuptojnë strukturën e formës së sonatës përmes shembujve dhe analizës.
3 KONSOLIDIMI – APLIKIMI DHE REFLEKTIMI
Teknika: Punë në grupe, prezantim, reflektim
FORMA E SONATËS
EKSPOZITA
ZHVILLIMI
RIPREZANTIMI
CODA
A - B
Zhvillimi i motiveve
K - B'
Përfundimi
• Nxënësit, në grupe, zgjedhin një vepër të shkurtër instrumentale dhe analizojnë formën e sonatës.
• Çdo grup paraqet skemën e formës dhe argumenton zgjedhjet e tij.
• Reflektim i përbashkët: Si ndihmon forma e sonatës për të krijuar interes dhe kontrast në muzikë?
Qëllimi:
Të zbatojnë njohuritë e fituara dhe të reflektojnë mbi funksionin e formës së sonatës.
REZULTATI I PRITSHËM: Nxënësit identifikojnë dhe shpjegojnë pjesët e formës së sonatës në vepra të ndryshme muzikore.

Tabela 2:Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën teknika dhe proceset muzikore

Rezultat i të nxënit	*Veprimtari praktike*
Njeh përmbajtjen poetike dhe melodike	**Hapi I: Dëgjim + tekst (15 minuta).** Mësuesi prezanton këngën përmes dëgjimit dhe kuptimit të tekstit /përmbajtjes së këngës. Ata analizojnë tekstin dhe melodinë e këngës. • Çfarë tregon teksti? • A është i trishtuar apo i gëzueshëm? • A përputhet melodia? **Hapi II:** Mësimi dhe interpretim këngës (25 minuta). Mësuesi u mëson këngën nxënësve me fraza dhe më pas e bashkon të gjithën nga fillimi në fund. **Hapi III: Reflektim (10 minuta):** Nxënësit diskutojnë: “Si ndikoi bashkëpunimi në interpretim? Si mund ta bëjmë më emocionues?” “Cili interpretim ishte më i mirë dhe pse?”.

Tabela 3:Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën historia, muzika dhe shoqëria

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike*
Vlerëson veprat sipas kontekstit	**Hapi I.** Mësuesi hedh pyetjen *"Si gjykojmë një vepër muzikore" duke vendosur për dëgjim* një pjesë klasike dhe një moderne. **Hapi II: Analizë (25 min.) (Kubimi)** U kërkohet nxënësve të plotësojnë gjatë dëgjimit të veprave muzikore: • Autorin • Periudhën • Stilin muzikor • Pse është e rëndësishme vepra që dëgjuan? Duke krahasuar ato dhe argumentuar p.sh.: • "Kjo vepër është më e strukturuar…" • "Kjo është më emocionale…" **Hapi III: Reflektim (10 minuta):**

	Nxënësit nxiten të diskutojnë “Mendoj se kjo vepër ka më shumë vlerë sepse…”

TEKNIKA E KUBIMIT
PËR VLERËSIMIN E MUZIKËS KLASIKE NË PERIUDHA TË NDRYSHME

ÇFARË ËSHTË?

Teknika e kubimit është një metodë vlerësimi që përdor gjashtë perspektiva të ndryshme (faqet e kubit) për të analizuar, kuptuar dhe vlerësuar një vepër muzike klasike në periudha të ndryshme.



SI PËRDORET?

- Zgjidh një vepër klasike.
- Analizo veprën nga secila faqe e kubit.
- Plotëso të gjitha pyetjet.
- Krahaso periudha të ndryshme.
- Nxirr përfundime dhe vlerësime personale.

FAQET E KUBIT	1 PËRSHKRUESE (Çfarë?)	2 ANALITIKE (Si është ndërtuar?)	3 KRAHASUESE (Ndryshime dhe ngjashmëri)	4 INTERPRETUESE (Çfarë dorëhënie ka?)	5 VLERËSUESE (Sa e rëndësishme është?)	6 PERSONALE (Çfarë mendoj unë?)
PYETJET KRYESORE	• Cila është vepra? • Kush është kompozitori? • Kur është krijuar? • Cila periudhë e muzikës klasike e përfaqëson?	• Cilat janë elementet muzikore kryesore (melodia, ritmi, harmonia, forma, dinamika)? • Si janë organizuar këto elemente në vepër?	• Si ndryshon kjo vepër nga periudhat e tjera (Baroku, Klasik, Romantik, 20. shek.)? • Çfarë ngjashmërish ka me vepra të tjera?	• Çfarë emocioni ose mesazhi përcjell vepra? • Çfarë mendon kompozitori të ketë shprehur përmes kësaj muzike?	• Cila është rëndësia e kësaj vepre në historinë e muzikës? • Si e vlerëson këtë vepër në krahasim me të tjera të së njëjtës periudhë?	• Si ndihesh kur e dëgjon këtë vepër? • Cila është pjesa që të pëlqen më shumë dhe pse? • A do ta rekomandoje këtë vepër? Pse?
SHEMBULL (VEPRË: Simfonia Nr. 5 L. van Beethoven)	Simfonia Nr. 5, Ludwig van Beethoven, krijuar në vitet 1804–1808, periudha Klasike.	Ka 4 lëvizje, fillon me motiv të famshëm me 4 nota, zhvillim tematik i fortë, dinamikë e kontrastuar.	Ndryshe nga Baroku (ku ka polifoni të ndërlikuar), Beethoven përdor formën klasike-sonatë dhe shprehje më personale.	Përcjell luftë, sfidë dhe fitore. Motivi i fatit që "troket në derë" – simbol i përpjekjes njerëzore.	Është një nga veprat më të njohura në muzikën klasike, ka ndikuar shumë kompozitorë pas tij.	Më frymëzon dhe më jep ndjesinë e forcës dhe shpresës. E preferuara është lëvizja e parë sepse ka shumë energji.

PËRFITIMET

- Zhvillon të menduarit kritik dhe analitik
- Ndihmon në kuptimin e thellë të muzikës
- Nxit krahasimin dhe vlerësimin objektiv
- Lidh emocionin me eksplorimin
- Forcon shprehjen personale dhe argumentimin

SHEMBUJ VEPRASH PËR T'U ANALIZUAR

- J. S. Bach – Toccata dhe Fuga në re minor (Barok)
- W. A. Mozart – Simfonia Nr. 40 (Klasik)
- L. van Beethoven – Simfonia Nr. 5 (Klasik)
- F. Chopin – Nokturnë Op. 9 Nr. 2 (Romantik)
- I. Stravinsky – "Riti i Pranverës" (Shek. XX)

Krijon CD / përdor teknologjinë	**Hapi I: Brainstorming (10 minuta)** Mësuesi hedh pyetjen: Çfarë është të krijosh një playlist me këngë apo melodi? A duhet të ketë një tematikë të caktuar kur krijojmë playlisting? **Hapi II: (25 minuta)** Mësuesi nxit nxënësit të krijojnë një playlist me 5–8 këngë. Ata kërkojnë duke përdorur *YouTube / Spotify g*jejnë këngët rendisin ato dhe përcaktojnë tematikën e këngëve të përzgjedhura. Nxënësit përgatisin: • listën e këngëve • arsyetimin për secilën • një prezantim (PowerPoint / video) **Hapi III: (10 minuta) Reflektim:** Nxënësit shpjegojnë krijimin personal të playlistit duke argumentuar p.sh.: "Zgjodha këto këngë sepse më japin energji para provimeve".

RN: KRIJIMI I CD/DVD SI MATERIALE MEDIMORE NË MUZIKË

HAPAT

1 PLANIFIKIMI
- Përcakto qëllimin mediмor
- Zgjidh temat/kapitujt
- Përgatit skenarin (përmbajtja muzikore)



2 MBLEDHJA E MATERIALEVE
- Regjistro audio (instrumente, vokal)
- Mbledh partitura, tekste, imazhe, video
- Kontrollo cilësinë e materialeve

3 PËRPUNIMI DHE REDAKTIMI
- Redakto audio (prerje, pastrim, nivelim)
- Përmirëso cilësinë e zërit (EQ, kompresim)
- Shto efekte nëse është e nevojshme

4 KRIJIMI I PËRMBAJTJES MULTIMEDIALE
- Kombino audio, partitura, tekste, imazhe, video
- Krijo prezantime/meny interaktive
- Strukturo kapitujt dhe navigimin

5 AUTORIMI I CD/DVD
- Përdor software autorimi (p.sh. Nero, Roxio, Adobe Encore)
- Shto menu, butona, lidhje
- Vendos strukturën e dosjeve

6 DJEGIA (BURN) E CD/DVD
- Zgjidh formatin (CD ose DVD)
- Përdor cilësi të lartë dhe shpejtësi të ulët
- Djeg dhe verifiko të dhënat

7 TESTIMI DHE PËRFUNDIMI
- Testo në kompjuterë të ndryshëm
- Kontrollo zërin, navigimin dhe linket
- Riprodho kopje rezervë (backup master)

TEKNIKA MEDIMORE NË MUZIKË

TEKNIKA AUDIO
- Regjistrim shumëkanalësh ose stereo me cilësi të lartë
- Sampling rate: 44.1 kHz / 16-bit (CD)
- Pastrim i zhurmave (noise reduction)
- Balancim dinamik (kompresor, limiter)
- Normalizim i volumit

TEKNIKA MIDI
- Përdor MIDI për shembuj dhe ushtrime
- Programim instrumentesh virtuale
- Sinkronizim MIDI me partitura/video

TEKNIKA MULTIMEDIALE
- Integrim i partiturave (PDF, imazhe)
- Video demonstrime (teknikë instrumentale)
- Animacione për teori muzikore
- Tekste shpjeguese dhe hiperlidhje

TEKNIKA INTERAKTIVE
- Menu kryesore dhe nënmenu
- Navigation me butona (next, back, home)
- Teste/kuiz interaktive
- Lidhje të jashtme (website, email)

FORMATI DHE STANDARDI
- CD-Audio për dëgjim të pastër muzikor
- CD/DVD Data për përmbajtje multimedia
- Formatet e rekomanduara:
  - Audio: WAV, MP3
  - Video: MP4
  - Dokumente: PDF
  - Imatge: JPG/PNG

PEDAGOGJIA MEDIMORE
- Përdor gjuhë të qartë dhe të kuptueshme
- Progresion i qartë i mësimit
- Shembuj praktikë dhe ushtrime
- Vlerësim dhe feedback për nxënësin

PRODUKTI PËRFUNDIMTAR

PËRFITIMET
- ✓ Material i qëndrueshëm dhe i ripërdorshëm
- ✓ Mësim i pavarur dhe i individualizuar
- ✓ Motivim më i madh i nxënësve
- ✓ Lehtësi në shpërndarje dhe ruajtjin

LËNDA: EDUKIM FIZIK, SPORT DHE SHËNDET

Tabela 1: Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën "Edukim nëpërmjet aktiviteteve sportive".

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 1 "Lojë popullore – 'Rrethi dhe ndjekësi'"*
Nxënësi njeh dhe zbaton rregullat e lojërave lëvizore popullore, duke marrë pjesë aktive, duke bashkëpunuar në grup dhe duke vlerësuar rëndësinë e tyre kulturore dhe fizike..	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë: "Sot do të zhvillojmë një lojë popullore që është luajtur ndër vite nga fëmijët dhe të rinjtë. Këto lojëra jo vetëm na argëtojnë, por edhe na ndihmojnë të jemi aktivë dhe të bashkëpunojmë. Pse mendoni se lojërat popullore janë të rëndësishme edhe sot?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi shpjegon rregullat e lojës "Rrethi dhe ndjekësi". Nxënësit formojnë një rreth dhe një nxënës vendoset si ndjekës jashtë rrethit. Loja zhvillohet duke ruajtur ritmin dhe rregullat. Nxënësit: • *respektojnë rregullat e lojës,* • *marrin pjesë aktive në lojë,* • *bashkëpunojnë dhe koordinohen me grupin,* • *tregojnë kujdes për sigurinë gjatë lëvizjes.* Zbatimi praktik: Nxënësit zhvillojnë lojën disa herë, duke ndryshuar rolet dhe duke përmirësuar koordinimin dhe reagimin. Loja mund të përshtatet me variante: • *ndryshim i ritmit të lojës,*

- *shtim i më shumë ndjekësve,*
- *zgjerim ose ngushtim i rrethit.*

Prezantimi: Nxënësit diskutojnë për përvojën e tyre gjatë lojës, duke treguar mënyrën si bashkëpunuan dhe si respektuan rregullat.

	Reflektimi: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë me pyetje: • *"Çfarë ju pëlqeu më shumë nga kjo lojë?"* • *"Si ndikojnë lojërat popullore në aktivitetin fizik dhe bashkëpunimin?"* • *"Pse është e rëndësishme të ruajmë dhe të luajmë lojëra tradicionale?"*

Tabela 2: Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën "Edukim nëpërmjet aktiviteteve sportive".

Rezultat i të nxënit	***Veprimtarive praktike 2 "Ushtrime në stolin gjimnastikor"***
Nxënësi demonstron saktë ekzekutimin e elementëve lëvizorë në stolin gjimnastikor, duke ruajtur ekuilibrin, koordinimin dhe sigurinë gjatë ushtrimeve.	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë: "Sot do të punojmë me stolin gjimnastikor dhe do të mësojmë disa elementë lëvizorë që kërkojnë ekuilibër dhe koordinim. Si mendoni, çfarë duhet të kemi parasysh për të ruajtur ekuilibrin dhe koordinimin, gjithashtu të jemi të sigurt gjatë ushtrimeve?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi demonstrim disa elementë bazë në stolin gjimnastikor (ecje mbi stol, kthime, ulje-ngritje, kalime anësore). Nxënësit i ndjekin dhe i praktikojnë fillimisht me ndihmë dhe më pas në mënyrë të pavarur. Nxënësit: • *ecin mbi stol duke ruajtur ekuilibrin,* • *kryejnë kthime dhe ndryshime drejtimi,*

	• *realizojnë ushtrime të thjeshta (ulje, kërcime të lehta),* • *respektojnë rregullat e sigurisë dhe radhën.* Zbatimi praktik: Nxënësit kryejnë një seri ushtrimesh të kombinuara në stol (p.sh. ecje + kthim + zbritje), duke u përqendruar te ekuilibri dhe koordinimi. Aktiviteti zhvillohet me variante: • rritje e vështirësisë së lëvizjeve, • kombinime më të gjata ushtrimesh, • punë në stacione të ndryshme. Prezantimi: Disa nxënës demonstrojnë kombinime ushtrimesh në stol, duke ruajtur kontrollin e pozicionit të trupit dhe saktësinë e lëvizjeve. Reflektimi: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë përmes pyetjeve: • *"Cilat ushtrime ishin më të vështira për ju?"* • *"Si e ruajtët ekuilibrin gjatë lëvizjes?"*

- *“Pse është e rëndësishme siguria gjatë ushtrimeve gjimnastikore?”*

Tabela 3: Shembull veprimtarie për përmbushjen e RN në tematikën "Edukim nëpërmjet aktiviteteve sportive".

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 3 "Kërcimi së larti – stili gërshërë"*
Nxënësi demonstron teknikën e kërcimit së larti në stilin "gërshërë", duke koordinuar vrapimin, shtytjen dhe kalimin mbi pengesë me siguri dhe kontroll.	*Prezantimi i situatës.* Mësuesi thotë:"Sot do të mësojmë kërcimin së larti me stilin 'gërshërë'. Realizimi i kërcimit kërkon koordinim të mirë mes vrapimit, shtytjes dhe kalimit të trupit mbi lartësi. Si mendoni, çfarë është më e rëndësishme për realizimin e kërcimit në lartësi?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi demonstron teknikën e kërcimit stilin "gërshërë në fazat: vrulli, rrahja, fluturimi (kalimi i thuprës) dhe rënia. Nxënësit imitojnë lëvizjet "gërshetimin" e këmbëve në vend dhe më pas e praktikojnë me lartësi të ulët. Nxënësit: • *realizojnë vrapimin e kontrolluar drejt vendit të rrahjes,* • *kryejnë rrahjen me një këmbë,* • *kalojnë mbi thupër duke ngritur këmbët në formë "gërshërë",* • *ruajnë balancën gjatë rënies.* *Zbatimi praktik:* Nxënësit praktikojnë kërcimin në disa prova, duke rritur gradualisht lartësinë. Aktiviteti zhvillohet me variante: • *fillimisht me lartësi të ulët → më pas më e lartë,* • *fokus te teknika → më pas te performanca,* • *punë individuale dhe në grupe për vlerësim dhe përmirësim.*

	Prezantimi: Disa nxënës demonstrojnë kërcimin para klasës, duke treguar koordinimin dhe teknikën e realizimit. *Reflektimi*: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë me pyetje: • *"Cila fazë e kërcimit ishte më e vështirë?"* • *"Si ndikoi vrulli në realizimin e kërcimit?"* • *"Çfarë duhet të përmirësoni për një kërcim më të mirë?"*

Tabela 4: Shembuj veprimtarish për përmbushjen e RN në tematikën "Aktiviteteve sportive".

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 1 "Basketboll (Zotërimi i topit në tabelë)"*
Nxënësi demonstron zotërimin e topit në tabelë në basketboll, duke përdorur teknikën e saktë të kërcimit, kapjes dhe kontrollit të topit në situata loje.	Prezantimi i situatës Mësuesi thotë:"Sot do të mësojmë si të zotërojmë topin në tabelë në basketboll. Ky element është shumë i rëndësishëm për të rifituar topin pas një gjuajtjeje të humbur. Si mendoni, çfarë duhet të bëjmë për të kapur topin më shpejt dhe më saktë se kundërshtari?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi demonstron teknikën e kërcimit për zotwrimin e topit, pozicionimin e trupit dhe kapjen e topit me dy duar. Nxënësit praktikojnë fillimisht pa kundërshtar dhe më pas në çifte. Nxënësit: • *pozicionohen pranë tabelës,* • *kryejnë kërcim të kontrolluar,* • *kapin topin me dy duar,* • *mbrojnë topin pas kapjes,* • *respektojnë rregullat dhe sigurinë.* Zbatimi praktik: Nxënësit praktikojnë situata reale loje, ku një nxënës gjuan dhe tjetri përpiqet të kapë topin në tabelë. Aktiviteti zhvillohet me variante: • *pa kundërshtar → me kundërshtar pasiv → aktiv,* • *zotërimi i topit në tabelë nga pozicione të ndryshme,* • *lojë me rregulla të thjeshta.*

Prezantimi: Disa nxënës demostrojnë teknikën e zotërimit të topit në tabelë, duke treguar kërcimin, kapjen dhe kontrollin e topit.

Reflektimi: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë me pyetje:

- *"Si ju ndihmoi pozicionimi për të kapur topin?"*
- *"Pse është e rëndësishme të kapim topin me dy duar?"*
- *"Si ndikon zotërimi i topit në tabelë në rezultatin e lojës?"*

Tabela 5: Shembuj veprimtarish për përmbushjen e RN në tematikën "Aktiviteteve sportive".

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 2 "Gjuajtje nga pozicione të ndryshme në volejboll"*
Nxënësi demonstron gjuajtje të topit në volejboll nga pozicione të ndryshme në fushë, duke përdorur teknikë të saktë dhe duke u përshtatur me situatat e lojës.	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë:"Sot do të praktikojmë gjuajtjet në volejboll nga pozicione të ndryshme në fushë. Në lojë reale nuk jemi gjithmonë në të njëjtin vend, prandaj duhet të dimë të godasim topin nga çdo pozicion. Si mendoni, çfarë duhet të kemi parasysh për një gjuajtje të saktë?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi demonstron gjuajtje të ndryshme (nga vija e parë, dhe e dytë), duke shpjeguar pozicionin e trupit dhe kontaktin me topin. Nxënësit praktikojnë në grupe të vogla duke ndryshuar pozicionet në fushë. Nxënësit: • *realizojnë gjuajtje nga pozicione të ndryshme,* • *përqendrohen te drejtimi dhe kontrolli i topit,* • *koordinojnë lëvizjen e trupit me gjuatjen,* • *respektojnë radhën dhe bashkëpunojnë* Zbatimi praktik: Nxënësit zhvillojnë ushtrime dhe situata të thjeshta loje duke gjuajtur topin nga pozicione të ndryshme. Aktiviteti zhvillohet me variante: • *gjuajtje në vend → në lëvizje,* • *gjuajtje në distanca të ndryshme,* • *lojë e thjeshtuar me fokus sulmin.*

	Prezantimi: Disa nxënës demonstrojnë gjuajtjet nga pozicione të ndryshme, duke treguar teknikën dhe saktësinë. Reflektimi: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë me pyetje: • *"Cili pozicion ishte më i vështirë për gjuajtje?"* • *"Si ndikoi pozicioni i trupit në drejtimin e topit?"* • *"Çfarë duhet të përmirësoni për të goditur më saktë?"*

Tabela 6 : Shembuj veprimtarish për përmbushjen e RN në tematikën "Aktiviteteve sportive".

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 3 "Organizimi i mbrojtjes në hendboll"*
Nxënësi zbaton organizimin e mbrojtjes në hendboll duke ruajtur pozicionin, mbuluar zonën dhe bashkëpunuar me shokët për të penguar depërtimin dhe gjuajtjet e kundërshtarit.	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë:"Sot do të mësojmë si të organizojmë mbrojtjen në hendboll. Një ekip i mirë nuk sulmon vetëm, por edhe mbron së bashku. Si mendoni, çfarë duhet të bëjmë për të ndaluar ekipin kundërshtar të shënojë?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi shpjegon dhe demonstron pozicionimin mbrojtës (qëndrimi përballë kundërshtarit, lëvizja anësore, mbulimi i zonës). Nxënësit punojnë në grupe dhe praktikojnë lëvizjet mbrojtëse pa dhe me kundërshtar. Nxënësit: • *marrin pozicion mbrojtës korrekt,* • *lëvizin në koordinim me shokët e ekipit,* • *mbulojnë zonën e tyre,* • *komunikojnë gjatë mbrojtjes,* • *respektojnë rregullat e lojës.* Zbatimi praktik: Nxënësit zhvillojnë situata loje (3x3 ose 5x5) me përparësi në mbrojtje. Aktiviteti zhvillohet me variante: • *pa kundërshtar → me kundërshtar pasiv → aktiv,*

- *ushtrime për mbulim zone,*
- *lojë e thjeshtuar me theks në organizimin mbrojtës.*

Prezantimi: Disa nxënës demonstrojnë pozicionimin dhe lëvizjen në mbrojtje, duke treguar bashkëpunimin dhe komunikimin në ekip.

	Reflektimi: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë me pyetje: • *"Si ndihmon bashkëpunimi në mbrojtje?"* • *"Pse është i rëndësishëm pozicionimi në fushë?"* • *"Çfarë mund të përmirësojmë në organizimin mbrojtës?"*

Tabela 7. Shembuj veprimtarish për përmbushjen e RN në tematikën "Edukim për shëndetin"

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 1 "Siguria gjatë aktivitetit fizik"*
Nxënësi identifikon rreziqet e mundshme gjatë aktivitetit fizik dhe zbaton rregulla bazë për parandalimin e dëmtimeve, duke përdorur pajisjet e duhura dhe duke respektuar teknikën e saktë të ushtrimeve.	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë:"Sot do të diskutojmë dhe praktikojmë si të mbrohemi nga dëmtimet gjatë ushtrimit fizik. Në çdo aktivitet sportiv ka rreziqe nëse nuk jemi të kujdesshëm. Çfarë mund të bëjmë për të shmangur dëmtimet?" Zhvillimi i aktivitetit: Mësuesi shpjegon dhe demonstron rregulla sigurie si: ngrohja para ushtrimeve, përdorimi i pajisjeve mbrojtëse dhe respektimi i teknikës së saktë. Nxënësit diskutojnë dhe praktikojnë ushtrime të thjeshta duke zbatuar këto rregulla. Nxënësit: • *kryejnë ngrohje para aktivitetit,* • *përdorin teknikën e saktë në ushtrime,* • *ruajnë distancën nga njëri-tjetri,* • *identifikojnë situata të rrezikshme,* • *përdorin pajisjet mbrojtëse kur është e nevojshme.* Zbatimi praktik: Nxënësit kryejnë ushtrime fizike të thjeshta duke zbatuar rregullat e sigurisë. Aktiviteti zhvillohet me variante: • *ushtrime me intensitet të ulët → mesatar,* • *identifikim i situatave të pasigurta në ushtrim,*

- *punë në grupe për kontroll dhe korrigjim të teknikës*.

Prezantimi: Disa nxënës përshkruajnë rregullat që zbatuan dhe tregojnë shembuj konkretë të shmangies së dëmtimeve gjatë ushtrimeve.

	Reflektimi: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë përmes pyetjeve: • *"Pse është e rëndësishme ngrohja para aktivitetit?"* • *"Cilat janë rreziqet nëse nuk zbatojmë rregullat e sigurisë?"* • *"Si mund të mbrojmë veten dhe shokët gjatë ushtrimeve?"*

Tabela 8. Shembuj veprimtarish për përmbushjen e RN në tematikën "Edukim për shëndetin"

Rezultat i të nxënit	*Veprimtarive praktike 2 "Sporti dhe shoqëria"*
Nxënësi analizon dhe argumenton rëndësinë e edukimit fizik dhe sportit në zhvillimin shëndetësor, social dhe kulturor të shoqërisë	Prezantimi i situatës. Mësuesi thotë: "Sot do të diskutojmë se si edukimi fizik dhe sporti ndikojnë në jetën tonë dhe në shoqëri. Pse është sporti i rëndësishëm jo vetëm për shëndetin, por edhe për bashkëjetesën dhe zhvillimin e shoqërisë?" Zhvillimi i aktivitetit: Nxënësit ndahen në grupe dhe diskutojnë mbi temat e dhëna, duke mbledhur ide dhe shembuj nga jeta e përditshme dhe sporti. Nxënësit: • *identifikojnë vlerat e sportit (shëndeti, bashkëpunimi, disiplina),* • *diskutojnë shembuj nga sportistë ose ekipe të njohura,* • *lidhin sportin me zhvillimin social dhe kulturor,* • *përgatisin argumente për prezantim.* Zbatimi praktik (mësim teorik): Çdo grup përgatit dhe prezanton një argument të shkurtër ose poster mbi ndikimin e sportit në shoqëri. Aktiviteti zhvillohet me variante: • *diskutim në grup,* • *prezantim me poster ose ndarje mendimesh,* • *debat i shkurtër mes grupeve.*

	Prezantimi: Grupet prezantojnë idetë e tyre dhe japin shembuj konkretë mbi ndikimin e sportit në jetën e individit dhe shoqërisë. • *cilat janë përfitimet e aktivitetit fizik dhe ndikimi i sportit në jetën e individit dhe shoqërisë.*  Reflektimi: Mësuesi udhëheq një diskutim të shkurtër në klasë, ku nxënësit shprehin mendimet e tyre Disa nxënës paraqesin përfundimet e tyre, duke treguar: • *"Si ndikon sporti në shëndetin dhe jetën tonë?"* • *"Çfarë na mëson sporti për bashkëpunimin dhe respektin?"* • *"Si mund të kontribuojmë ne për një shoqëri më aktive dhe të shëndetshme?"*